

numër 13
gusht 2018

toka

IMF

REVISTË PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



**MBLEDHJE E SHPEJTË
DHE EFIKASE**



SFIDAT E REJA TË POLITIKËS SË PËRBASHKËT BUJQËSORE EVROPIANE 2020-2027



**Panxhari
– shfrytëzuesi
më i mirë i
fosforit**



**Gardh
elektrik në
pemëtore**



**Bletët e
afrikanizuara
ndryshe nga
ato joafrikane**



**Mbrojtja nga
breshri me rrjeta
kundër breshrit**




**MBJELLJA E
DOMATEVE NË
TË NJËJTIN VEND
SI KULTURË E DYTË**

8

**ARI I GJELBËR
ME SHUMË
VITAMINA**



11



**SËMUNDJE
TE BIMËT
TË CILAT E KANË
NDRYSHUAR
HISTORINË**

12

**BAKTERET
TE FASULJA**



16



**MBJELLJE ME
PËRPUNIM
MINIMAL
TË TOKËS**

19

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FNF, AGRINET, AGROPUKA, IKC për Shqipëri-në, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit të suazat e sektorit bujqësor.



**FEDERATA NACIONALE
E FERMERËVE**

Toka ime, gusht 2018

Botues: FFRM

**Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Gigo Mihajlovski, nr. 4-1/1,
1000 Shkup**

Udhëheqës: Bllagojçe Najdovski

Tel/faks: 02 3099042

e-mail: mojazemja@gmail.com

**Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:
Biljana
Petrovska-Mitrevska**
**Botuar më:
gusht 2018**

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska

Gazetar: Nita Haxhihamza Gashi

Bashkëpunëtorë profesionale

**Dr. Vitor Malutaj, Tomi Pikuli, Nikolin Karapanci,
Sabah Djaloshi, Besmira Aliaj, Ekrem Bajrami,
Dipl. agr. Vanko Zahariev, Dipl. agr. Stojan Gligorov,
Despina Kërstevska, Dr. Zlatko Arsov, Ivan Vangelov,
Dr. Dragi Tanevski, Shqipe Shaqiri**

Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]



**FEDERATA NACIONALE
E FERMERËVE**

FEDERATA NACIONALE E FERMERËVE

**Adresa: rr. Gigo Mihajlovski nr.4 1000 Shkup
Tel: 00 389 (0)70 937132
e-mail: nfff@nff.org.mk
uebfaqe:www.nff.org.mk**



AGROPUKA

**Adresa: Lagjja e Re, Pukë
Tel.+355 212 2 2412. Mob.:+355 68 23 88 169/
+35569 57 42 060/ +35567 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
uebfaqe: www.agro-puka.org**



AGRINET ALBANIA

**Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
uebfaqe: www.agrinet.al**



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY

**Adresa: rr. Gjon Serreçi, p.n, Ferizaj, Kosovë
Tel: 038742190, Mob:+377 (0)44 368 356
Faks: 038742190
e-mail:main@ngoikc.org
uebfaqe:www.ngoikc.org**



**WeEffect – Qendra Suedeze për Kooperativa, punon me
organizatat partnere në mbi 20 vende, me vizion të botës
së qëndrueshme dhe të drejtë të çliruar nga varfëria.
WeEffect e mbështet revistën rajonale "Toka Ime" me
qëllim që të zhvillohet lëvizja e bujqve në Ballkan dhe të
përfordhet zëri i përbashkët i bujqve.**

BLERJA, PUNA DHE IDILI I FSHATIT

C mimet e ulëta blerëse, mos-harmonizimi i legjislativës, repromaterialet më të shtrenjta, përfshirja e vogël e të rinjve në bujqësi, ndikimi negativ i ndryshimeve klimatike mbi bujqësinë, migrimi i zmadhuar fshat-qytet, vlerësimi i vogël i mundit të bujkut, sidomos i grave fermere, shoqatat e dobëta dhe bashkëpunimi i vogël rajonal – këto janë problemet kryesore me të cilat ballafaqohen bujqit në rajon. Pikërisht këto tema i përpunon Toka Ime, si revistë rajonale, dhe me rekomandime konkrete do të këmbëngulë të ndikojë në zgjidhjen e problemeve dhe sfidave. Pikërisht zbatimi i aktiviteteve dhe bashkëpunimit të përbashkët mund të ndikojnë në hedhjen e hapave përpara në këtë sektor të rëndësishëm ekonomik për të gjithë ne. Kjo shpjegohet nga ak-

tivitetet e FNF-së, IKC-së, Agrinetit dhe Agropukës të mbështetura nga organizata suedeze “We Effect” për zhvillim të bujqësisë dhe shoqërimit kooperativ në rajon.

Edhe përkrah ajrit të mirë, freskisë në vapën verore, aromës së këndshme të shiut veror, më e mira e Ballkanit ndjehet në fshat, që është një nga vendet më tërheqëse në të gjitha shtetet në këtë rajon.

Me respekt,
mr. Biljana Petrovska
Redaktore e revistës “Toka Ime”





SFIDAT E REJA TË POLITIKËS SË PËRBASHKËT BUJQËSORE EVROPIANE 2020-2027


Shkruan: Bllagoçe Najdovski

Politika e përbashkët bujqësore (PPB) është një prej politikave më të rëndësishme dhe më të vjetra të BE-së. Nga vendosja e saj në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar, kur është vendosur ajo, garanton standartet më të larta botërore të mbrojtjes dhe sigurisë së cilësisë së ushqimit në Evropë. Ajo është ndryshuar disa herë me qëllim që të përshtatet me nevojat e reja të qytetarëve evropianë dhe me sfidat globale.

Edhe pse edhe mandej ka për qëllim mbështetjen e bujqve evropianë dhe të sigurojë furnizimin me ushqim në BE, Politika e përbashkët bujqësore evropiane është shumë më tepër se kaq. BE-së i nevojitet sektor bujqësor rezistent, i qëndrueshëm dhe konkurrent, i cili do të mund të prodhojë ushqim cilësor të sigurt dhe me çmime të volitshme për qytetarët e BE-së. Por edhe të ketë një strukturë të fuqishme social-ekonomike në mjediset rurale, kurse PPB-ja ka një ndikim të madh në këtë drejtim.

BUXHETI I PPB-së PËR PERIUDHËN 2020-2027

Komisioni Evropian propozon që buxheti i PPB-së për periudhën 2021 deri në 2027 të jetë 365 miliarda euro, që do të thotë se për PPB-në BE-ja do të japë diçka më pak se një të tretën e buxhetit të përgjithshëm të BE-së, dhe kështu theksohet rëndësia e cila do t'i jepet në të ardhmen kësaj politike. Buxheti i PPB-së do të ndahet në dy shtylla kryesore: pagesa të drejtpërdrejta për bujqit dhe pagesa për masat tregtare dhe për zhvillimin rural. Për përshtatje me PPB-në shtetet anëtare përkundrejt prioritetëve të veta në sektorin bujqësor do të kenë mundësi 15% të mjeteve personale në suazat e PPB-së t'i transferojnë midis këtyre dy shtyllave. Përveç kësaj do të kenë fleksibilitet për transferim të 15% mjeteve shtesë nga shtylla e parë në shtyllën e dytë për masa në fushën e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike pa kofinancim. Mandej, 10 miliarda euro do të jenë në dispozicion të programit kërkimor të BE-së për mbështetje të kërkimeve dhe risive në pjesën e ushqimeve, bujqësisë dhe zhvillimit rural.



MËNYRË E RE PUNE E PPB-SË

Puna e PPB-së në të ardhmen do të lehtësohet shumë dhe do të modernizohet fushëveprimi i politikës. Theksi i politikës nuk do të jetë në rregullat, por në rezultatet dhe suksesi. Qasja e deritanishme e njëjtë për të gjithë do të zëvendësohet me qasje fleksibile dhe shteteve anëtare të BE-së do t'u jepet liri më e madhe në marrjen e vendimeve mbi mënyrën më të mirë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta, por njëkohësisht do të theksohen edhe nevojat specifike të bujqve dhe bashkësive rurale në shtetet anëtare. Me PPB-në e re do të nxitet zbatimi më i madh i teknologjive të reja. Në aspektin e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike do të zbatohet sistem për kontroll që të sigurohet se bujqit dhe shtetet anëtare do t'i plotësojnë obligimet e veta.

- Në nivel të BE-së do të përcaktohet një shumë e vetme e qëllimeve të PPB-së me të cilat do të përcaktohet se çfarë dëshirohet të arrihet me këtë politikë në aspektin e bujqve, qytetarëve dhe klimës etj.
- Në nivel të BE-së do të dakordohen shumë masa me të cilat do të përcaktohet se në çfarë mënyre shtetet anëtare do të mund të përdorin mjetet e dhëna dhe çdo shtet mund të përzgjedhë dhe të zhvillojë masa të veçanta të cilat do të jenë më të mirat për plotësimin e nevojave personale specifike.
- Në nivel të BE-së do të dakordohet dhe shuma e përbashkët e treguesve të rezultateve që të sigurohen kushte të barabarta për konkurrencë gjatë vlerësimit të efikasitetit të masave të ndërmarra.
- Çdo shtet anëtar i BE-së do të zbatojë analizë gjithëpërfshirëse për nevojat e veta specifike dhe pastaj do të përgatisë plan strategjik në suazat e PPB-së, ku do të tregojë se si planifikon t'i përdorë mjetet nga të dyja shtyllat e PPB-së, cilat instrumente do t'i zbatojë dhe do t'i përcaktojë vlerat qëllimore specifike.
- Çdo plan strategjik në suazat e PPB-së duhet të miratohet nga Komisioni Evropian që të sigurohet se ai plan është në përputhje me qëllimet e përgjithshme të BE-së dhe kështu të mos shkatërrohet natyra e përbashkët e politikës dhe tregut të vetëm dhe të mos ketë mbingarkesë të shfrytëzuesve dhe administratës.
- Shtetet anëtare do të dorëzojnë në Komision raporte vjetore mbi suksesin ku do të tregojnë përparimin drejt qëllimeve të përbashkëta në bazë të treguesve të veçantë të rezultateve. Komisioni Evropian do t'i shqyrtojë raportet dhe sipas nevojës do të propozojë masa dhe rekomandime për përmirësim të zbatimit.

Shtetet anëtare mund të vendosin se cilat masa do të japin rezultatet më të mira në përputhje me rrethanat e veta.

Ndihmë për bujqit me zgjidhje të përshtatura drejt rezultateve dhe jo drejt procedurave. Çdo shtet do të përpunojë plane strategjike në suazat e PPB-së me pasqyrë të masave të përzgjedhura dhe të rezultateve të dëshiruara dhe ato do të miratohen dhe do të ndiqen vazhdimisht nga Komisioni.

Mbështetja e drejtpërdrejtë bujqve u garanton stabilitet dhe parashikim. Në bazë të treguesve dhe të rezultateve të përcaktuara paraprakisht do të vlerësohet përparimi në arritjen e qëllimeve në çdo shtet. Më tepër subvencione për fermerët që do të bëjnë më tepër se kërkesat minimale dhe gjoba më të ashpra për përparimin e pamjaftueshëm. Sistem i ri për ndjekje dhe drejtim në zbatimin e procedurave të politikës me shpërblime dhe gjobitje.

BE-ja do të marrë pjesë në të gjitha fazat kështu që do të përcaktohen rregullat, do të vlerësohen planet, do të ndiqet përparimi dhe realizimi i politikës.

PPB-ja mbështetet në 9 qëllime të qarta të cilat e reflektojnë qasjen ekonomike, ekologjike dhe shoqërore të politikës, sepse PPB-ja edhe mandej do të sigurojë qasje në ushqim cilësorë si dhe theksojnë ndryshimet klimatike dhe mjedisin jetësor.

9 QËLLIMET E PPB-SË

1. Sigurimi i të ardhurave të drejta
2. Zmadhimi i konkurrencës
3. Ekuilibrimi i raportit të fuqive në zinxhirin e sigurimit të ushqimit
4. Lufta kundër ndryshimeve klimatike
5. Mbrojtja e mjedisit jetësor
6. Ruajtja e natyrës dhe shumëllojshmërisë së universit biologjik
7. Mbështetja e rinovimit të gjeneratës
8. Rajone rurale dinamike
9. Mbrojtja dhe cilësia e ushqimit dhe shëndetit.

UDHËZIM MË I MIRË DREJT SISTEMIT TË DREJTË

Në PPB-në e re theksi do të vendoset mbi mbështetjen e ekonomive bujqësore të vogla dhe të mesme dhe nxitjen e të rinjve që të merren me bujqësi.

- Komisioni propozon që të zvogëlohen pagimet prej 60 000 euro e më sipër me vendosjen e kufirit të partë për pagim mbi 100000 euro për ekonomitë bujqësore ku do të merren parasysh shpenzimet për fuqinë e punës. Kështu do të sigurohet shpërndarje më e drejtë e pagimeve.
- Shtetet anëtare do të duhet të sigurojnë mbështetje më të madhe për hektar për ekonomitë bujqësore të vogla dhe të mesme.
- Minimum 2% e mjeteve të dhëna për pagime të drejtpërdrejta në çdo shtet anëtar do të veçohet për ndihmë të bujqve të rinj, kështu që do të zmadhohet mbështetja që të formojnë ekonomi bujqësore maksimum deri në 100 000 euro.
- Çdo shtet duhet të mundësojë që vetëm bujqit e vërtetë ta marrin këtë ndihmë.
- Sektorë të caktuar bujqësorë që kanë vështirësi edhe mandej do të marrin ndihmë shtesë për përmirësim të konkurrencës dhe cilësisë.



POLITIKA NË PJESËN PËR MJEDISIN JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Bujqit, tashmë, kanë një rol të madh në luftën kundër ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetin. PPB-ja e re do të jetë edhe më e rreptë dhe bujqit do të kenë mbështetje shtesë që të marrin pjesë në programe të ndryshme vullnetare.

JOOBLIGUESE PËR BUJQIT

- Bujqit të cilët do të bëjnë më tepër se ajo që është përcaktuar në aspektin e obligimeve për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike do të shpërblehen.
- Shtetet anëtare do të përpilojnë programe për ekologjinë që të nxisin bujqit të përvetësojnë praktika të cilat ndikojnë pozitivisht mbi klimën.

E OBLIGUESHME PËR BUJQIT


- Të gjitha pagesat e drejtpërdrejta do të varen nga plotësimi i kërkesave të rrepta për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe klimës.

Obligimet e reja përfshijnë:

- Ruajtjen e tokës së pasur me qymyr, mbrojtjen e moçaleve dhe kënetave.
- Mjetet e obligueshme për menaxhim me materiet ushqyese për përmirësim të cilësisë së ujit.
- Rotacionin e kulturave.
- Minimum 30% e mjeteve të dëkuara për financim të shtyllës së dytë do të shpenzohen për masa në lidhje me ndryshimet klimatike dhe mjedisin jetësor.
- 40% e mjeteve të buxhetit të përgjithshëm të PPB-së duhet të veçohen për masa për mbrojtje nga ndryshimet klimatike.
- Ndjekje vjetore e përparimit.
- Ndërprerje e pagesës në rast të rezultateve shumë të dobëta.
- Rezervë prej 5% të mjeteve të dedikuara për zhvillimin rural si shpërblim për shtetet anëtare që do t'i plotësojnë qëllimet e veta për mbrojtjen e klimës, mjedisit jetësor dhe biodiversitetin.
- Obligim i shteteve anëtare një pjesë të pagesave të drejtpërdrejta t'i veçojnë për bujqit të cilët do të përfshihen në programe të veçantë për ekologjinë.
- Sinergji më e mirë me politikat dhe programet e tjera të BE-së në pjesën e klimës dhe mjedisit jetësor. P.sh. Programi LIFE.
- Kushte të përshtatshme për shkëmbim të njohurive, investime, risi dhe bashkëpunim.

BUJQËSIA SI BAZË E SHOQËRISË EVROPIANE

Bujqit kanë rolin kryesor në bashkësitë rurale evropiane. Me PPB-në e re do të vazhdohet të nxitet zhvillimi i bashkësive rurale dinamike dhe të ndihmohen bujqit që t'i përmbushin pritjet e opinionit në aspektin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit.



- Më tepër masa për nxitjen e gjeneratave të reja që të merren me bujqësi; mbështetje nga BE-ja për programet lokale si mentorim të cilin bujqit e rinj e marrin nga bujqit më të vjetër dhe përmirësim i bashkëpunimit midis gjeneratave.
- Nxitje e shteteve anëtare që të bëjnë më tepër në nivel nacional në lidhje me fleksibilitetin e rregullave për trashëgimi dhe tatim me qëllim që bujqit e rinj të kenë qasje më të lehtë te tokat bujqësore.
- Më tepër fleksibilitet për shtetet anëtare gjatë përpilimit të masave më të mira për zhvillimin rural që të zmadhohet rritja dhe punësimi duke përfshirë edhe fshatra të mençur.
- Rregulla më të rrepta për bujqit në pjesën e plotësimin të pritjeve shoqërore në aspektin e ushqimit – rregull për mbrojtjen e cilësisë së ujit, zvogëlim i përdorimit të pesticideve dhe zvogëlim i përdorimit të antibiotikëve të kafshët.
- Politika e zhvillimit rural do të kontribuojë në shumëllojshmërinë e ekonomive rurale.

ZBATIM MË I MADH I NJOHURIVE DHE INOVACIONEVE

Njohuritë dhe inovacionet janë me rëndësi enorme për një sektor bujqësor të qëndrueshëm. PPB-ja do të ketë investime më të mëdha në kërkime dhe inovacione dhe do të veçojë 10 miliarda euro për inovacione në fushën e ushqimit, bujqësisë dhe zhvillimit rural.

- Stimulim i digjitalizimit të ekonomive bujqësore.
- Stimulim i shteteve anëtarë që të përdorin teknologji të reja për kontroll dhe ndjekje – A plotësohen kërkesat në lidhje me rotacionin e kulturave.



Mbjellja e domateve në të njëjtin vend si kulturë e dytë

Shkruan: dipl. agr. Stojan Gligorov

Që të arrihen rezultate optimale është shumë e rëndësishme të dihet se sa bimë duhet të mbillen në një sipërfaqe prej një metër katror ose m^2 dhe si të mbillen ato. Përveç se është i rëndësishëm për madhësinë e frutës, numri i bimëve në m^2 , ndikon theksueshëm edhe mbi numrin e frutave në bimë, si tufa apo veshulë. Një prej detyrave tona duhet të jetë edhe dhënia e këshillave prodhuesve mbi mënyrën e drejtë të mbjelljes së bimëve për m^2 .

Pas prodhimit të filizave cilësorë vjen në rend edhe mbjellja.

Mbjellja sipas rëndësisë është një ndër masat agroteknike më të rëndësishme për vetë arsyen se mbjellja si duhet e bimës te domatja është parakusht që të arrihet një prodhim cilësor dhe rendiment i lartë.

Mbjellja e tufës së gabuar të bimëve është gabim i cili nuk mund të korrigjohet.

Që të arrihen rezultate optimale është shumë e rëndësishme të dihet se sa bimë duhet të mbillen në një sipërfaqe prej një metër katror ose m^2 dhe si të mbillen ato. Përveç se është i rëndësishëm për madhësinë e frutës, numri i bimëve në m^2 , ndikon theksueshëm edhe mbi numrin e frutave në bimë, si tufa apo veshulë. Një prej detyrave tona duhet të jetë edhe dhënia e këshillave prodhuesve mbi mënyrën e drejtë të mbjelljes së bimëve për m^2 , sepse:

- tufë e dendur – luftë më e madhe për ushqim nga sistemet rrënjor;
- hijezim i ndërsjellë;

- pranishmëri më e madhe e sëmundjeve, ajrim më i dobët, lagështia më e madhe relative e ajrit, kurse pas-taj ndodh edhe zmadhimi i kushteve për shfaqjen e sëmundjeve të kërpudhave.

Disa detyra të paraprake të cilat duhet të kryhen:

- sipërfaqja duhet të punohet si duhet;
- t'u kushtohet vëmendje masave agroteknike dhe fitosanitare si edhe përzgjedhjes së parcelës;
- rekomandohet që të kryhet dezinfektim termik i truallit;
- analizë e truallit dhe ujit;
- plehërim i drejtë bazë dhe mbrojtje nga insektet tokësore;
- vendosje e sistemit pikë për pikë;
- çdo rresht duhet të ketë shirirtin e vet;
- vendosje si duhet e mbulesës metalike në rastin kur përdoret;





- largësia e rreshtave të bimës dhe dendësisë së pikatoreve;
- pikatoret duhet të jenë të vendosura gjithmonë nga lart;
- mbjellja kryhet kur kemi kushte të përshtatshme (temperatura, lagështia, drita, përgatitja e sipërfaqes dhe filizi etj.).

Para se të mbillen shënohen zakonisht rreshtat dhe bimët në resht. Thellësia e mbjelljes së bimës së domates lëviz deri te zona e kotiledoneve, jo më thellë sepse qafa e rrënjës është mjaft e ndjeshme dhe gjatë lagështisë më të madhe sëmuren madje shkaktohet dhe shkatërrim i të gjitha të mbjellave. Zakonisht tek ne, në praktikë, domatja kultivohet në reshta të njëfishtë dhe shumë rrallë në reshta të dyfishtë.

Zënia rrënjë si fazë e cila vjen pas mbjelljes si masë e rëndësishme dhe prej saj varet zhvillimi i mëtejshëm i bimës. Sistemi rrënjor zhvillohet drejt

nëse largësia në resht është si duhet, gjithashtu, e rëndësishme është edhe largësia midis rreshtave, por ajo varet nga hibridi apo lloji i domates.

Filizi më i madh, i vjetërsuar, zë rrënjë me vështirësi dhe prandaj duhet të praktikohet që filizat e tillë të mos mbillen sepse ka vonesë në prodhimtari dhe humbet prodhimi dhe rendimenti.

Shpërhapja e ujit në sipërfaqe, është, gjithashtu, një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të bimës, si dhe përzgjedhja e llojit të pikatoreve. Prodhuesit shpesh nën ndikimin e reklamave dje këshillave joprofesionale gabojnë gjatë zgjedhjes së sistemit pikë për pikë dhe llojit të pikatoreve si edhe gjatë përcaktimit të llojit të tokës.

Ujitja tej mase dhe e shpeshtë mund të shkaktojë mbytje të sistemit rrënjor si rezultat i regjimit të pabalanuar ujë-ajër.

Që të jepet ushqim si duhet gjatë vegjetimit duhet të njihen nevojat e bimës gjatë çdo faze të zhvillimit. Nevojiten analiza më të shpeshta të trullit dhe ujit që të ndiqet mungesa e materieve ushqyese apo edhe ushqimi i tepërt. Kështu që së bashku me ujitjen kryhet edhe ushqimi i bimës me mikro dhe makro elementë. Në pjesën e dytë të vegjetimit nevojitet më tepër kalium në truall. Nëse vihet re ndonjë mungesë (cilësi e keqe, gjethe të vogla, lule të vogla, plasaritje e frutës) prodhuesi duhet të konsultohet me person ekspert për tejkalimin e mangësisë së shfaqur.

Një prej fazave më të rëndësishme të zhvillimit të domates është pllenimi. Lulja e domates është dygjinore që do të thotë që përmban edhe pistil dhe vezore. Kultivimi i kulturës së dytë kërkon lagështi relativisht më të lartë në ajër, sepse pllenimi dhe zënia e frutës të jetë më i suksesshëm.

Pllenimi me brumbuj është mënyra më efikase dhe tek ne zbatohet shpesh në sipërfaqe më të mëdha, por ka edhe disa mangësi:

- aktiviteti i brumbujve zvogëlohet në temperatura ekstreme gjatë pllenimit si kulturë e dytë, ose ai ndalon tërësisht;
- çmimi i brumbujve është mjaft i lartë.

Përveç brumbujve zbatohet edhe përdorimi i hormoneve, sirenës etj. Mbrojtja e domates së mbjellë është faktor prej të cilit, nëse mbjellja është kryer me filiz të shëndetshëm dhe cilësor dhe nëse janë zbatuar masa cilësore dhe fitosanitare, ka mundësi që me mbrojtje minimale të ketë një prodhimtari cilësor. ●





Panxhari – shfrytëzuesi më i mirë i fosforit

Shkruan: agr. i dipl. Stojan Gligorov

Panxhari është një bimë e pasur me vitamina dhe minerale. Kjo bimë është kultivuar prej kohësh në këto hapësira, por që të ketë cilësi më të mirë duhet të zbatohen masa agroteknike. Ai është bimë dyvjeçare e cila ka vegjetacion relativisht të shkurtër. Panxhari është bimë e rajoneve të ftohta dhe fara mugëllon në temperaturë prej 50C, kurse në temperaturë prej 100C mbin për 10 ditë. Bimët e reja durojnë temperaturë nga -3 deri në -4 gradë.

Panxhari mund të durojë ngrica të shkurtra prej -2 deri në -4 gradë. Temperatura optimale për rritje dhe zhvillim është 15-23 gradë, temperaturat në 10 dhe mbi 30 gradë e ngadalësojnë zhvillimin.

Panxhari kërkon shumë dritë dhe prandaj nuk rekomandohet që të kultivohet midis të mbjellave. Uji në fazat e para të zhvillimit është i nevojshëm, kurse në fazat më të vonshme nevojat për ujë janë mesatare. Duhet të ujitet në periudhën e verës nga qershori deri në gusht kur mbjelljet kanë një masë gjethesh të zhvilluar mirë.

Përpunimi i tokës është shumë i rëndësishëm që të zhvillohet mirë pjesa e trashë e rrënjës së panxharit prandaj duhet të bëhet lesim i thellë i shtresës së tokës. Thellësia e lërimit të tokës për mbjellje të panxharit duhet të jetë 30 centimetra. Përpunimi bazë i tokës kryhet në vjeshtë në thellësi prej 10 deri në 20 cm. Pastaj para mbjelljes kryhet përpunim kompleks i tokës me lërim, lesim, kurse në sipërfaqe më të vogla gjatë kultivimit dhe në parapërgatitjen për mbjellje të tokës hidhen plehra.

Për dallim nga kulturat e tjera perimore, panxhari e shfrytëzon më mirë fosforin. Rezultate më të mira jep në raport 20-10kg/ha azot, 100 kg/ha fosfor dhe 100-150kg/ha kalium. Rezultate të përkryera merren edhe me hedhjen e plehut organik në sasi prej 40 tonësh për hektar.

Mbjellja kryhet drejtpërdrejt nga fara e cila që të mbijë më shpejt laget me ujë të ngrohtë me temperaturë nga 22-23 gradë për dy ditë me radhë. Pastaj fara thahet dhe mbillet. Kjo mund të trajtohet me biostimulues dhe të dezinfektohet.

Panxhari mbillet në largësi midis radhëve prej 45 deri në 50 centimetra, kurse në radhë 10-15 cm. Rrallimi i bimës kryhet me makineri, nëse të mbjellat janë shumë të dendura, ai mund të bëhet në fazat e vonshme nga dita e 40 deri në ditën e 50 të mbledhjes provë. Përpunimi midis radhëve mund të kryhet pas çdo mbledhjeje, pas çdo ujitjeje apo shiu më të fortë. Thellësia e përpunimit duhet të jetë nga 3 deri në 5 centimetra. Vjelja mund të bëhet me makineri ose me dorë. Nëse panxhari ruhet, duhet të planifikohet që të lihen kërcëj të gjeteve me gjatësi prej 2 centimetrash, me lagështi prej 96 deri 100% dhe temperaturë rreth 0 gradë celsius. Ai mund të ruhet deri në 5 muaj, kurse në kushte të kontrolluara me ventilim të kontrolluar edhe deri në 8 muaj. ●

Mbjellja kryhet drejtpërdrejt nga fara e cila që të mbijë më shpejt laget me ujë të ngrohtë me temperaturë nga 22-23 gradë për dy ditë me radhë. Pastaj fara thahet dhe mbillet. Kjo mund të trajtohet me biostimulues dhe të dezinfektohet.



Ari i gjelbër me shumë vitamina

Shkruan: agr. i dipl. Stojan Gligorov

Rukola, apo e njohur edhe si “ari të gjelbër e romakëve”, është një sallatë që rritet kryesisht në rajonet bregdetare të Detit Adriatik. Klima mesdhetare i përshtatet dhe ajo shpesh mbillet si zbukurim në kopshte. Kjo kulturë, e cila përgatitet si sallatë dhe përdoret si shtesë me patate të ziera dhe peshk mund të mbillet edhe në vendin tonë.

Rukola ka kërkesa modeste për ngrohtësi dhe është rezistente ndaj temperaturave të ulëta dhe ngricave. prandaj mund të prodhohet gjatë gjithë sezonit. Mund të mbillet në çdo lloj toke, por më mirë është që toka të ketë pH neutrale apo të jetë tokë alkale.

Gjatë vapës së verës duhet të jenë nën hije, në të kundërt gjethet do të kenë cilësi të ulët.

RUKOLA KA KËRKESA MODESTE PËR NGROHTËSI DHE ËSHTË REZISTENTE NDAJ TEMPERATURAVE TË ULËTA DHE NGRICAVE. PRANDAJ MUND TË PRODHOHET GJATË GJITHË SEZONIT. MUND TË MBILLET NË ÇDO LLOJ TOKE, POR MË MIRË ËSHTË QË TOKA TË KETË PH NEUTRALE APO TË JETË TOKË ALKALE.

Përpunimi i sipërfaqes ku mbillet rukola është e njëjtë si të perimet e tjera gjethore. Përpunimi bazë i tokës nuk duhet të jetë më i thellës e 20 centimetra, sepse rukola prodhohet vetëm me mbjellje të drejtpërdrejtë nga fara, kurse fara është shumë e imët me masë prej (1.000 fara në 15 gram). Ajo mbillet nga shkurti deri në shtator disa herë në periudhë nga 15 deri 30 centimetra, kurse mbillet 5 deri në 10 centimetra nga bima në bimë. Thellësia e mbjelljes duhet të jetë rreth një centimetër, kurse mbin për disa ditë.

Rukola plehërohet me 60 deri në 80 kg azot, 60 deri në 80 kg fosfor dhe 100 deri në 120 kg kalium për një hektar në raport NPK 1:1:2.

Kjo bimë kërkon përpunim midis radhëve gjatë vegjetimit dhe ujitjes. Pas mbjelljes, vlera e konsumit të rukolës arrin 40 deri në 60 ditë kur mund të mblihet. ●



Rukola është bimë njëvjeçare ose dyvjeçare e cila kultivohet për shkak të gjetheve që kanë shije pikante dhe të ashpër dhe janë të pasura me vitamina, sidomos me vitaminë C. Rukola ndikon në mënyrë stimuluese mbi organizmin e njeriut, sidomos lukthin dhe sistemin e tretjes. Në kërcellin e shkurtër në fazën vegetative rriten gjethe. Gjethet janë të dhëmbëzuara dhe mund të jenë të gjata edhe deri në 20 cm dhe të gjera deri në 6 cm. Gjatë temperaturave më të larta mund të lëshojë dhe lule me ngjyrë të bardhë ose të verdhë të çelur me vija violetë. Fruta është me fara të rrumbullakëta të imëta me peshë deri në 2 gram.



SËMUNDJE TË BIMËT TË CILAT E KANË NDRYSHUAR HISTORINË

Shkruan: prof. dr. Zlatko Arsov

Që nga zanafilla e prodhimtarisë bujqësore njeriu është ballafaquar me organizma të ndryshëm dëmtues midis të cilëve hyjnë edhe shkaktuesit e sëmundjeve të bimët. Sot nuk ka asnjë bimë e cila nuk është sulmuar nga të paktën një sëmundja. Vlerësohet se humbjet në prodhimtarinë bimore nga organizmat e dëmshëm (dëmtues, sëmundje, barëra të këqija etj.) janë rreth një e treta e të ardhurave. Në shtetet më pak të zhvilluara humbjet janë edhe më të mëdha dhe

ndonjëherë arrijnë deri në 50% të të ardhurave potenciale. Vlerësimet dëshmojnë se për shkak të sëmundjeve të bimëve humbet rreth 10 deri në 12% e prodhimtarisë vjetore.

Në fillimet e prodhimtarisë bujqësore humbjet kanë qenë të shpeshta dhe të mëdha, kurse sëmundjet e bimëve kanë luajtur rol të rëndësishëm për këtë humbje. Në atë kohë nuk dihej pse ndodhin sëmundjet të bimët dhe kush i shkakton ato. Romakët i kanë organizuar rubigalet e famshme duke e lutur perëndinë Robigus që t'ua ruajë grurin nga zjarre që të kenë me se të ushqehen. Historia është plot me shembuj të tillë. Nga mesi i shek. XIX (1853) është dëshmuar shkençërisht kush i shkakton sëmundjet të bimët. Së pari janë zbuluar kërpudhat, pastaj bakteret, viruset dhe në fund fitoplazma si shkaktues të sëmundjeve të bimët.

Sëmundjet në bujqësi shkaktonin dëme të mesha. Disa prej tyre kanë ndikuar në mënyrë drastike ose të theksuar mbi popullatën duke shkaktuar uri, migrim të popullatës ndryshime të shprehive të njeriut, shkatërrimin e një numri të madh fermash, kompanish, falimentim të bankave etj.

ERGOTIZËM

Shfaqje drastike të disa sëmundjeve të bimët të cilat kanë ndikuar mbi historinë njerëzore ka shumë, por ne do të prezantojmë vetëm disa prej tyre. Ergotizmi është sëmundje që shfaqet te njeriu dhe te kafshët kur ata përdorin ushqim i cili përmban thekër me vrugë, shkaktues i të cilës është kërpudha *Claviceps purpurea*. Këto kërpudha formohen te kallinjët e thekrës dhe përmbajnë alkaloidë ku përfshihen edhe LSD-ja, komponentë halucinues të fortë. Simptomat e ergotizmit te njeriu janë të ndryshme, nga dridhja e majave të ekstremiteteve (pëllëmba, gishtat, shputa), temperatura e lartë trupore, halucinimet, degradimi mendor, abortimi, mosfunksionimi i gishtërinjve të këmbëve dhe duarve për shkak të qarkullimit të dobët të gjakut dhe deri te shfaqja e gangrenës. Konsumimi i sasive të mëdha të bukës së infektuar ka çuar deri në vdekje. Ndryshime të ngjashme shfaqen edhe te kafshët që janë ushqyer me krunde thekre prej thekrës së kontaminuar apo prej kashtës e cila ka pasur kërpudha të tilla. Te kafshët ka shkakuar dështim, humbje të apetitit, rënie në peshë, zvogëlim në prodhimin e qumështit, humbje të bishtit etj. Ergotizmi sot nuk është ndonjë sëmundje



e rëndësishme. Njeriu nëpërmjet njohuri shkencore është ballafaquar me efikasitet me këtë sëmundje. Megjithatë në mesjetë kanë vdekur me mijëra njerëz pikërisht nga kjo sëmundje, kurse nuk dihej shkaku i shfaqjes së saj. Sëmundja ka qenë e njohur si "organ i shenjtë" për shkak të temperaturës së lartë dhe dridhjes së duarve dhe këmbëve. Kjo sëmundje është shfaqur sidomos në Francë për shkak të përdorimit të bukës së kontaminuar. Aty ergotizmi është quajtur "zjarri i Shën. Antonit" ndoshta sepse murgjit e Shën. Antonit i kanë mjekuar me sukses njerëzit e sëmurë duke i ushqyer me bukë thekre të shëndetshme. Kjo sëmundje, në Evropë kohë pas kohe është shfaqur edhe më pas. Ergotizmi e ka ndryshuar kursin e historisë së paku njëherë. Dihet që Petër Veliki nuk ka arritur t'i mbajë nën kontroll portet në Detin e Zi (1772) sepse ushtarët e tij janë ushqyer me bukë thekre ku ka pasur kërpudha skleroze, kurse kuajt nuk ishin të gatshëm sepse edhe ata i kanë ushqyer me thekër të tillë.



Patatja e ka prejardhjen nga Andet peruane nga Amerika e Jugut. Në Evropë është sjellë në shek. XVI (1556-1565). Në territorin e ish Jugosllavisë patatja ka ardhur rreth vitit 1785. Në Evropë patatja është zgjeruar shpejt për shkak të kushteve të përshtatshme klimatike dhe të tokës. Kështu që në vitin 1849 patatja është bërë ushqim kryesor për irlandezët. Në atë kohë një irlandez hante mesatarisht mbi dy kilogram patate në ditë. Patatja kultivohej me lehtësi dhe në sipërfaqe të vogla dhe ka mjaftuar si ushqim për njerëzit, prandaj popullata e Irlandës ka përparuar në dekadat e para të shek. XIX. Gjatë vitit 1840 në Amerikën e Veriut është vënë re dukuria e vrugut të patatja. Gjatë vitit 1845 kjo sëmundje, të cilën së pari e kanë quajtur epidemi "kolera e patates", kurse më vonë "vrugu i patates" (shkakues ohytophthora infestans), është shfaqur në Evropë. Sëmundja e ka zënë Irlandën për dallim nga vendet e tjera evropiane të cilat e kanë kultivuar edhe kultura të tjera për ushqim përveç patates dhe nuk ishin të varura nga prodhimi i patates. Meqenëse në Irlandë patatja është shkatërruar, Irlandën e përfshiu "uria irlandeze". Nga kjo uri kanë vdekur një milion banorë në Irlandë, kurse një milionë të tjerë janë shpërngulur në shtetet përtëj oqeanike. Aty kanë pranuar çfarëdo lloji pune vetëm që të mbijetojnë. Edhe sot në Boston dhe Nju Jork policët dhe zjarrfikësit janë kryesisht irlandezë.

NJOLLAT GRI TË MISRIT

Me zbulimin e misrit hibrid, të ardhurat filluan të zmadhohen menjëherë duke arritur në numër të jashtëzakonshëm prej 10-15000 kg/ha për kokërr të thatë. Misri hibrid ka shkaktuar treg enorm të farës. Që të përballohet konkurrenca në treg e farës hibride të misrit, kompanitë filluan të përdorin linjë me sterilitet të meshkujve, kurse ato gjene trashëgoreshin nëpërmjet citoplazmës së bimës amë. Gjeni për sterilitet mashkullor te bimët amë është quajtur "sterilitet mashkullor teksian i citoplazmës" (Texas cytoplasmic male sterility, CMS). Në praktikë, kur përdoren CMS linja sterile mashkullore bimët amë tek bima amë nuk duhet të hiqet fshesa. Kjo e ka bërë shumë të lirë prodhimtarinë e farës. Nga ana tjetër, ta që kanë përdorur mënyrë konvenciale të prodhimtarisë, te linjat amë duhet ta heqin fshesën. Si të tilla, ato janë më të shtrenjta dhe nuk janë konkurrue-

se në treg. Prandaj shumë prodhues të farës në SHBA janë munduar të përdorin linjën CMS. Përdorimi i saj ka zgjatur vetëm disa vite, kur në vitin 1970 u shfaq një lloj i ri sëmundjeje prej kërpudhave Cochliobolus heterostrophus (Helminthosporium maydis), që lidhej me përdorimin vetëm të një linje mashkullore sterile, kurse e cila nuk ka qenë rezistente ndaj sëmundjes. Sëmundja është shfaqur në gjethe dhe në kalli. Patogjeni shpërhapet nga era dhe ka zënë një hapësirë enorme, nga Florida drejt pjesës veriore të SHBA-së. Sëmundja e re ka shkatërruar mbi 15\$ të prodhimtarisë së farës në SHBA: Është vlerësuar se humbjet i kanë tejkaluar një miliarda dollarë. Shkencëtarët kanë reaguar shpejt dhe kanë paralajmëruar se në vitin 1971 prodhimi i misrit në SHBA do të rrezikohet nëse nuk ndryshohet prodhimtaria e farës së misrit.

NJOLLAT GRI TË ERRËTA TE LULEDIELLI

Në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar ka nisur krijimi i lulediellit hibrid. Rezultatet e para kanë qenë të jashtëzakonshme. Luledielli hibrid ka dhënë të ardhura të larta dhe cilësi të mirë. Për shkak të interesit të madh për një lulediell të tillë sipërfaqet me këtë lloj bime në ish Jugosllavi përfshinin një sipërfaqe prej 180 000 ha. Por, sukcesi nuk zgjati shumë. Me shpërhapjen e lulediellit hibrid në një sipërfaqe edhe më të madhe u shfaq dukuria e sëmundjes së re (e ngjashme si CMS-ja e misrit hibrid në SHBA), që e shkaktoi kërpudha Phomopsis helianthi dhe kjo sëmundje është shpërhapet nga era, prandaj të ardhurat e lulediellit ranë menjëherë. Kështu që sipërfaqja prej 180 000 ha në vitin 1979 është zvogëluar në 36.000 gjatë vitit 1980. Në fillim të viteve tetëdhjetë ndodh mungesa e lulediellit, prandaj prodhohet vaj soje, i cili ka cilësi më të keqe se ai prej luledielli. Kështu që qytete të tërë mbanin erë peshk të skuqur, sepse vaji i sojës duhet të përdoret i ftohtë, kurse gjatë skuqjes mban errë të keqe. Me kultivimin e materialit gjenetikisht të njëjtë (hibrid) në sipërfaqe të mëdha, është i ndjeshëm ndaj sëmundjeve të reja, u bënë dëme enorme në prodhimtari. Shkenca ka reaguar shpejt duke kërkuar burime të rezistencës të llojet rezistente, të cilat me procese përzgjedhëse injektohen te hibridet e reja. Në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjetë prodhimtaria e lulediellit u stabilizua, kurse sot është në nivel të kënaqshëm.



MBROJTJA NGA BRESHRI ME RRJETA KUNDËR BRESHRIT

TË MBJELLAT SHUMËVJEÇARE SI DHE KULTURA TË TJERA NË VENDIN TONË, NË MASË MË TË MADHE APO TË VOGËL JANË TË RREZIKUARA NGA BRESHRIT. BRESHRI SHFAQET NË SHPESHTËSI DHE INTENSITET TË NDRYSHËM DHE TË PAPARASHIKUESHËM. NDRYSHIMET KLIMATIKE GLOBALE REFLEKTOHEN NË DY MËNYRA: BRESHRI BIE GJITHNJË DHE MË SHPESH, KURSE TOPAT E AKULLIT JANË MË TË MËDHENJ NË DISA RASTE ARRIJNË MADHËSINË E NJË TOPI TENISI.

Shkruan: Despina Kërstevska

Të mbjellat shumëvjeçare si dhe kultura të tjera në vendin tonë, në masë më të madhe apo të vogël janë të rrezikuara nga breshrit. Breshri shfaqet në shpeshtësi dhe intensitet të ndryshëm dhe të paparashikueshëm. Ndryshimet klimatike globale reflektohen në dy mënyra: breshri bie gjithnjë dhe më shpesh, kurse topat e akullit janë më të mëdhenj në disa raste arrijnë madhësinë e një topi tenisi. Është e logjikshme që prodhuesit e frutave dhe rrushit të luftojnë me këto fatkeqësi kohore. Breshri gjithmonë e më shpesh shoqërohet me erë të fortë dhe me stuhi, kështu që kombinimi i tillë shkakton dëmtime dhe lëndime të organeve mbitokësore të frutave me pasojë dëmtuese shumëvjeçare. Për mbrojtjen e të mbjellave shumëvjeçare nga breshri zbatohet: Sistemi kundër breshrit predha Raketa; ngritja e e rrjetave kundër breshrit. Në disa shtete përdoren aeroplanë që t'i pastrojnë retë që shkaktojnë breshër nëpërmjet lëshimit të lodur argjendi në re.



Rrjetat kundër breshrit, sidomos te të mbjellat e reja, bashkëkohore, të dendura po bëhen pjesë përbërëse e kopshtarisë moderne. Ato ofrojnë mbrojtjen më efikase nga breshri. Më shpesh përdoren në kopshtari në shtetet e zhvilluara evropiane (Itali, Francë dhe shtetet anëtare të BE-së). Rëndësi dhe zbatim më të madh kanë në mbrojtjen e llojeve e frutave me produktivitet të lartë dhe në prodhimin e materialit për mbjellje. Si faktor kufizues i kësaj mase për mbrojtje nga breshri janë çmimet e larta për zbatim të sistemit prej 10 000 eurosh për hektar. Përdorimi i rrjetave kundër breshrit mundëson mbrojtje të tërësishme të prodhimit, si edhe të vetë bimëve, dhe në kushte të temperaturave të larta i mbron bimët nga djegia. Është e rëndësishme të theksohet se rrjetat kundër breshrit duhet t'i mbrojnë në mënyrë efikase bimët me karakteristika të pandryshueshme për disa dekada. Që të arrihet kjo, rrjeta kundër breshrit duhet të jetë me karakteristika mekanike të larta.

SHTYLLA

Baza e rrjetave kundër breshrit janë shtyllat mbështetëse dhe mbajtëse, në të cilat më vonë vendoset dhe përforcohet rrjeta kundër breshrit. Sistemi mund të vendoset në shtylla betoni ose druri. Shumë rrallë ndodh që në pjesën e brendshme të vendosen shtylla druri, kurse ato të jashtmet, kryesoret, të jenë prej betoni. Largësia midis shtyllave maksimum është nga 8-10 m.

SHTYLLA BETONI

Shtyllat e betonit përdoren në rajone të cilat nuk kanë shtylla përkatëse prej druri, në rajonet të cilat kanë toka gurore ku shtyllat nuk mund të ngulen thellë, si dhe në rajonet të cilat nuk kanë ngriç të mëdha (Itali, Greqi, Spanjë). Përdoren shtylla prej betoni cilësor me lartësi minimale – gjatësi prej 4,0 m për shtyllat e brendshme dhe minimum 4,5 për shtyllat anësore dhe në qoshe. Lartësia e shtyllave varet nga: lartësia e pemëve frutore (llojeve të rrushit), largësia midis radhëve (sistem i vendosjes së rrjetës mbrojtëse – i rrafshët ose i pjerrët), lartësia e mekanizmave që përdoren. Gjatë përpunimit të shtyllave prej betoni përdoren kallëpe të veçanta, në të cilët përgjatë në një largësi të caktuar vendosen tela për përforcim. Pastaj hidhet një përzierje betoni me cilësi të lartë, e cila nuk duhet të përmbajë materialesh organike. Shtyllat lihen një kohë të caktuar që të thahen dhe të përforcohen, kurse pastaj nxirren. Telat

për përforcim mund të mblidhen dhe kështu në ndonjë mënyrë e mblidhin edhe shtyllën, me çka mbahet masa në një largësi të caktuar. Nuk rekomandohet shtylla me prerje të tërthortë më të vogël se 7*7 cm, në çdo 8 m, ose 8*8,5 cm (me 12 tela përforcues në prerjen e shtyllës). Në fund të parcelave përdoren shtylla me prerje më të madhe 9*9,5 cm (me 18 tela përforcues) ose më të trashë, në varësi nga gjatësia e radhës. Përparësitë e shtyllave prej betoni janë: fortësia w madhe (janë të shtylla kryesore dhe për shtylla të fundit) dhe qëndrueshmëria. Anë negative të shtyllave prej betoni janë: elasticiteti i vogël dhe tendenca për thyerje, pesha mjaft më e madhe (janë më të rënda gjatë nguljes dhe fundosen më thellë) është e nevojshme të përdoren pllaka mbajtëse të veçanta kundër fundosjes, që e zmadhon më tepër çmimin e shtyllave prej betoni, kanë kërkesa të mëdha teknologjike për përpunim (lartësi 4,5 m, kurse prerje 7 deri në 8 cm), kanë pore dhe zbrazëti të vogla në sipërfaqe të tyre, ku fshihen pore dhe insekte të cilat për një periudhë të caktuar kohore shkaktojnë sëmundje të bimët, gjatë verës pjesa mbitokësore e shtyllës është deri në 30 gradë celsius më e ngrohtë, nga ajo nëntokësore, kurse gjatë dimrit është po kaq më e ftohtë. Prandaj rrënjët e bimëve që janë në kontakt me shtyllën (1-12 prej numrit të përgjithshëm të bimëve) janë nën stres që ndikon në prodhimtari.

SHTYLLA PREJ DRURI

Shtyllat prej druri përdoren në territorin e Evropës, sepse kanë disa përparësi: janë më të lehta se ato prej betoni, ngulen më lehtë, janë më elastike, mbajnë më lehtë pesha të kombinuara, nëse janë të mbingarkuara përkulen, por nuk thyhen, përshtaten më mirë me ambientin, nuk fundosen në thellësi, lyhen me rrëshirë me bazë bakri kështu që në poret e tyre nuk mund të mbijetojnë dëmtues dhe insekte, nuk ka dallim temperature dhe probleme me sistemin rrënjor të bimës. Janë më të lira se shtyllat prej betoni rreth 10-15% për shkak të sasisë më të vogël të pajisjes. Mangësi: jetëgjatësia është e njëjtë me jetëgjatësinë e të mbjellave dhe nuk mund të transportohen nga një vend në tjetrin. Më shpesh përpunohen prej druri i cili përmban rrëshirë: bredh, pishë, dëllinjë, shumë rralle prej bagremi, kurse në literaturë theksohen karakteristikat e përkryera mekanike të mësh-teknës ruse e cila është 50% më e fortë se dëllinja dhe 38% më e fortë se pisha. Prodhuesit e shtyllave prej mësh-teknës



ruse japin garanci deri në 40 vjet. Gjatë përzgjedhjes së shtyllave prej druri është e rëndësishme të përzgjidhen ato shtylla tek të cilat solucioni për lyerje depërton minimum 2-3 cm, kurse ideale është nëse arrin deri në bërthamën lëkundëse, ose e përfshin gjithë pjesën e drurit.

RRJETA KUNDËR BRESHRIT

Përpunohen me thurje ose endje të fijeve prej polietileni dhe janë shumë rezistente ndaj dritës së diellit. Kriteret themelore për një rrjetë cilësore janë: qëndrueshmëri minimale prej 25 vjetësh, pesha mbajtëse minimale 600 kg/m. Qëndrueshmëria e rrjetës kundër breshrit baret nga trashësia e fijes e cila mund të jetë nga 0,28 deri në 0,32 mm. Është e rëndësishme që rrjeta të jetë stabile, të mos ketë vrima. Më shpesh përdoren rrjeta me sytha me madhësi prej 2,8-2,9 x 8,0-9,0 mm, kurse kjo është madhësia që nuk lëshon asnjë kokërr breshri. Dendësia e endjes dhe diametri nuk ndikojnë mbi peshën e rrjetës e cila është 30-90 g/m² dhe mund të jetë tregues i rrjetës cilësore. Rrjeta peshën më të madhe e ka në vendet ku lidhet me kabllo (në mes) dhe në vendet ku lidhen dy rrjeta fqinje (anët) sepse në ato pjesë është më e fortë. Rrjetat prodhohen me ngjyra të ndryshme: të bardhë, të gjelbër deri në të zezë. Ngjyra e rrjetës ndikon mbi sasinë e dritës të cilën e lejon rrjeta të kalojë. Drita më lehtë kalon nëpër rrjetën e bardhë, kurse më vështirë nëpër rrjetën e zezë, e cila gjendet edhe më shpesh. Gjatë temperaturave të larta në periudhën verore, rrjetat kundër breshrit me hije e zvogëlojnë temperaturën nën rrjetë me 2-3 gradë celsius, kështu zvogëlohet edhe mundësia e shfaqjes së djegies së gjetheve dhe frutave. Gjatë temperaturave shumë të ulëta, nën rrjetë gjatë ditës temperatura është 2-3 gradë celsius më e lartë se në mjedisin përreth, pa ndonjë mbrojtje të theksuar nga rrjeta. Përveç kësaj përdorimi i rrjetës kundër breshrit mund të shkaktojë: zmadhim të lagështisë në ajër 10-15%; zvogëlim të shpejtësisë së erës deri në 50%; zvogëlim të intensitetit dhe zgjatjes së rrezatimit fotosintetik 12-17%. ●



BAKTERET E FASULJA

Shkruan:

Inxh.bujq. i dipl. Vanço Zahariev

Kultivimi i fasules dhe bishtajës mund të pengohet ose pamundësohet përveç sëmundjeve të tjera edhe nga sëmundje shkaktues të të cilave janë bakteret. Tek ne dëme më të mëdha apo më të vogla shkaktohen nga bakteri *Xanthomonas campestris* pv. *phaseoli* (Smith) i cili shkakton sëmundjen e plagë bakterore, pastaj bakteri *Pseudomonas syringae* pv. *phaseolicola* (Bukholder) dhe bakteri *Cortobacterium* (*Clavibacter*) *flaccumfaciens* (Hedges) shkaktues i venitjes bakterore të fasules dhe bishtajës.

PLAGA BAKTERORE mund të shkaktojë dëme të theksuar në të dyja kulturat. Simptomat shfaqen në të gjitha pjesët mbitokësore të bimës. Gjatë mbjelljes së farës së prekur nga ky bakter një pjesë e bimës zhduket kur mbin. Pas kotiledoneve (çifti i parë i gjetheve të gjelbra të çelura) shfaqen njolla uji të cilat nëse e kapin edhe majën e zhvillimit, kotiledonet mbeten të paçelura, kurse

bimët që kanë mbirë vdesin. Në masën e vërtetë gjetheve simptomat shfaqen në formë të njollave të vogla si pika të cilat më vonë bëhen më të mëdha me ngjyrë të kuqe në kafe të rrethuara me një kurorë të hollë – rrip me ngjyrë të verdhë. Nëse kushtet janë të përshtatshme dhe njollat e kapin pjesën më të madhe të gjetheve ato deformohen, digjen dhe bien. Kurse nëse bakteri futet edhe në enët përçuese të bimës fillon të dallohet edhe marrja ngjyrë kafe në sistemin dytësor të enëve të gjetheve pas së cilës edhe ena kryesore e gjetheve merr ngjyrë kafe dhe gjetheja bie. Nëpër kërcej dhe degë shfaqen njolla me ngjyrë të gjelbër të errët të cilat dalëngadalë bëhen me ngjyrë të kuqe në kafe. Tek bishtajat e gjelbra simptomat shfaqen si njolla të imëta uji të cilat më vonë errësohen dhe thahen. Farat në këto bishtaja mbeten të imëta dhe me ngjyrë të verdhë. Nga të gjitha pjesët e rrëzuara të bimës, sidomos nga fara del një lëng i verdhë i cili thahet si një lloj luspe e hollë. Bakteri shkaktues i kësaj sëmundjeje është negativ dhe aneorob mbijeton në farë nga 5-7 vjet, kurse te mbetjet e tjera të bimës bakteri jeton deri në kalbëzim të

saj dhe aftësia për të infektuar zhduket nga mikroorganizmat e tjerë.

Shpërhapja e sëmundjes ndodh nga shiu, insektet, gjatë zbatimit të masave agroteknike, sidomos kur bima është e lagur. Zhvillim i fuqishëm i sëmundjet vërehet në temperatura mesatarisht të lartë, gjatë reshjeve të shumta, vesave të mëdha dhe lagështisë relativisht të lartë të ajrit. Mbjellja në tokë shumë të lagësht ndihmon në zhvillimin e shpejtë të sëmundjes. Bimët janë shumë të ndjeshme në periudhën e lulëzimit gjatë së cilët sulmohen më fuqishëm gjetet e poshtme më të vjetra. Që të kontrollohet dukuria dhe zgjerimi i sëmundjes është e nevojshme që fara të jetë nga të mbjella tërësisht të shëndetshme, dizinfektimi i farës duke e nxjerrë në diell për dy javë si dhe pastrim të farave të sëmura. Gjithashtu, masat agroteknike dhe mbledhja duhet të kryhen kur nuk do të ketë aspak vesë. Gjatë shfaqjes së simptomave të para të sëmundjes dhe kushteve të përshtatshme për zhvillim të saj duhet të kryhet trajtim me 1% Bordeaux mixture dhe preparate të tjera me bazë bakri.

Në prodhimtarinë për shitje mjafton një trajtim, kurse për prodhimin e farës nevojiten dy trajtime. Nevojitet dhe shkatërrim i kujdesshëm i pjesëve të bimëve në fund të vegjetimit dhe përdorim i llojeve më rezistente.

PLAGA UNAZË (AUREOLË) te fasulja dhe bishtaja janë të ngjashme me simptomat e shfaqura nga plaga bakterore dhe ato varen në një shkallë të lartë nga kushtet e mjedisit. Nëse janë mbjellë fara të sëmura, sëmundja do të zhvillohet sistematikisht kështu që në disa raste ka karakter akut të shprehur nëpërmjet zhvillimit të shpejtë të saj, dukuria e zverdhjes dhe venitjes së gjetheve të poshtme e ndjekur nga vdekja e parakohshme e bimës. Në raste të tjera në bimët e infektuara sëmundja zhvillohet më ngadalë kështu që gjethet e bimëve të infektuara marrin ngjyrë të verdhë, kurse majat e gjetheve deformohen. Gjatë ditës bimët vyshken kurse gjatë natës përsëri ripërtërihen dhe kjo ndodh deri në fund me formimin dhe pjekjen e bishtajave me farë të arritur. Zhvillimi lokal i sëmundjes manifestohet nëpërmjet dukurisë së njollave të veçanta ngjyrë kafe në kotiledone ose njolla të shumta të imta (1-4 mm) dhe të lëmuara nëpër gjethë të cilat mandej thahen. Simptomat më karakteristike sipas të cilave ka marrë emrin dhe dallohet kjo sëmundje është shfaqja e një aureole (unazë) me gjerësi (1-3cm) dhe ngjyrë të gjelbër të çelur rreth njollës e cila është rezultat i toksinave të caktuara të bakterit. Për dallim nga sëmundja e lartpërmendur njollat këtu shfaqen shumë rrallë bashkohen me njëra-tjetrën duke kryer shkatërrim të tërësishëm ose të pjesshëm të gjethes.

Nëpër kërcëj kjo sëmundje formon prerje të lëmuara përgjatë tyre me kurorë të kuqe në kafe të cilat te bimët e reja shpesh edhe plasin. Nëpër bishtaja njollat janë të shumta, të imta dhe të rrumbullakëta dhe përfundojnë me një kurorë kafe. Farat e sëmura janë të verdha ose me ngjyrë bezhë dhe me mbirje të ulët. Nëpër to villen re ënjtje të imëta me formë si ënjtjet e bëra nga insektet. Nga të gjitha pjesët e sëmura të bimës rrjedh eksudat bakteror-sekrecion bakteror. Shkaktes i kësaj sëmundjeje është bakteri i cili mund të shfaqen në dy lloje në varësi nga reagimi i bimës. Nëpër fasule dhe bishtajë shpërhapet nëpërmjet farës së infektuar, plagëve dhe nëpërmjet stomave të bimës. Zhvillimi kryhet në sistemin përçues të bimëve nga kalon në indin e parenkimës.

Për dallim nga shkaktuesi i mëparshëm ky bakter zhvillohet në temperatura më të ulëta prandaj edhe shfaqja më e hershme në raport me bakterin e mëparshëm kur bimët janë në faza më të ndjeshme prandaj dëmet janë më të mëdha. Temperatura optimale për zhvillimin e saj është 20 gradë celsius dhe për dallim nga bakteri i mëparshëm i sulmon gjethet e sipërme, kurse më pak ato të poshtmet te bimët.

Shkatërrimi i kësaj sëmundjeje kryhet njëjtë si edhe në sëmundjen e mëparshme.

VYSHKJA BAKTERORE E FASULES është sëmundje e cila shkakton humbjen e bimëve të reja, kurse zhvillimi i bimëve të tjera është i pamundshëm. Nëpër gjethë shfaqet si njollë ku indi është i vyshkur dhe vdes, kurse në kërcell shfaqet si djege me ngjyrë kafe përgjatë tij, dhe në ato vende bimët thyhen. Edhe pse rrallë, tek bishtajat shfaqen cepa prej të cilëve rrjedh sekrecioni bakteror.

Bakteri shkaktues i kësaj sëmundjeje mbijeton në mbetjet bimore deri në 2 vjet, kurse në farë deri në 25 vjet. Infektimi në bimëve e kryen vetëm nëpërmjet plagëve dhe zhvillohet

në enët përçuese, kurse më rrallë në parenkimë dhe në inde të tjera të bimës. Sëmundja shfaqet më fuqishëm në temperatura të ajrit nga 16-28 °C dhe lagështi të ulët të ajrit nga rrjedh se në rajone të thata mund të bëjë dëme të theksuara ekonomike. Për shkatërrim të saj rekomandohet mbjellje njëherë në tre vjet fasule, përdorim i farës së shëndetshme të painfektuar dhe kontroll i kohë pas kohe i të mbjellave me qëllim që të hiqen dhe shkatërrohen bimët e sëmura.



PLAGË E ZAKONSHME BAKTERORE (flakë) - *Xanthomonas campestris* pv. *phaseoli* SIMPTOMA NË GJETHE DHE POSHTË SIMPTOMA NË BISHTAJË DHE KOKËRR



PLAGË AREOLË OSE UNAZË (flakë) *Pseudomonas syringae* pv. *phaseolicola*- Simptoma në gjethë dhe poshtë simptome në bishtajë dhe kokërr



VYSHKJE BAKTERORE TE FASULJA - *Cortobacterium* (*Clavibacter*) *flaccumfaciens* SIMPTOMA NË GJETHE



VYSHKJE BAKTERORE TE FASULJA - *Cortobacterium* (*Clavibacter*) *flaccumfaciens* SIMPTOMA NË BISHTAJA DHE KOKËRR

Gardh elektrik në pemëtore

Shkruan: Ivan Vangellov

Energjia elektrike, për dallim nga baruti, i cili ndonjëherë përdoret për mbrojtjen e pronës bujqësore, mund të thuhet me siguri se është formë relativisht e lirë për largimin e mysafirëve të paftuar në pemëtore. Përveç largimit të kafshëve të egra mund të përdoret edhe si roje, për shembull, kuajt apo lopët dhe kafshët e tjera, dhe është dëshmuar si një zgjidhje më e mirë dhe më humane, sesa për shembull, teli me gjemba, që përdoret (dhe përdoret ende kohë pas kohe) pa energji elektrike. Ndikimi elektrik shfaqet gjatë kontaktit me të dhe është i pakëndshëm si për kafshët ashtu edhe për njerëzit. Gardhi elektrik është dizajnuar si zgjidhje humane, sepse vetëm ky ndikim i largon kafshët nga kontakti i mëtejshëm dhe qasje te rajoni i rrethuar me gardh. Kuptohet se, duhet marrë gjithmonë parasysh se ka mundësi që ndonjë kafshë që gjendet në suazat e gardhit për një kohë më të gjatë mund të ngordhë, ose nga stresi ose nga uria. Domethënë, edhe pse gardhi është vendosur që të funksionojë në mënyrë të pavarur dhe afatgjatë, është e domosdoshme që kohë pas kohe të kontrollohet se a funksionon. Gardhi elektronik, nëse është efikas dhe i vendosur mirë, do ta tërheqë vëmendjen e derrave të egër apo të kafshëve të tjera me goditje elektrike kur kafsha do të prekë telin. Në kushte normale, gardhi i vendosur funksionon si qark i hapur, kështu që kur kafsha

(njeriu) do të prekë telin, qarku mbyllet dhe ndodh zbrazja. Impulset elektrike udhëtojnë nëpër trupin e kafshëve të cilat ushqehen në afërsi të gardhit dhe energjia elektrike shkakton një tronditje më të vogël apo më të madh të kafshët. Gjithashtu, gjatë kontaktit të parë me gardhin mund të ndodhë që gardhi të çahet nga kafsha e tronditur, por me kalimin e kohës kafshët e egra e anashkalojnë atë. Nuk duhet të harrohet se disa objekte dhe/ose materiale të tjera duke përfshirë edhe vetë vegjetacionin në kontakt me gardhin, mund të krijojnë, gjithashtu, qark pjesërisht apo tërësisht të mbyllur. Kjo do të shkaktojë që të zvogëlohet më shumë apo më pak tensioni dhe të mos largohen kafshët, si dhe të jenë shkak për ulje të tensionit të gardhit dhe prandaj vegjetacioni përreth qarkut duhet të ndiqet dhe mirëmbahet. Që arinjtë, derrat e egër dhe kafshët e tjera të mos kenë mundësi ta kalojnë lehtë gardhin, nëse ka pemë në afërsi, gardhi duhet të përbëhet nga minimum pesë (apo më tepër) tela në varësi nga konfigurimi i terrenit.

Ekzistojnë dy variante të vendosjes së gardhit në varësi nga terreni dhe qëllimi i vendosjes. Në këtë artikull do të përmendim dy lloje:

- Gardhi elektrik me tel
- Gardhi elektrik me rrjetë.

Gardhet elektrike kanë performancat të njëjta pavarësisht nga materialet



prej të cilat përpunohen, por për funksionim të tyre më e rëndësishme është tokëzimi i mirë, kurse në terrene me shumë gurë dhe të thatë përpunohet varianti 2. Gjithashtu, është e rëndësishme edhe vetë gjatësia e gardhit dhe mënyra e furnizimit të tij me energji. Në parim nëse ka energjia elektrike në dispozicion pajisja vendoset në rrjetin e përhershëm nëse nuk ka energji elektrike vendose t panel solar prej 20 vatësh me akumulator prej 12 amperësh sepse pajisja që krijon impulse është konsumator i vogël 400 (mA) është varianti më i lirë për mbushje të saj dhe transport të sigurt të vetë pajisjeve.

Materialet e nevojshme për përpunim

- shtylla druri ose betoni 120-150 cm.
- tel ose rrjetë
- mbajtës dhe izolues të telit
- pajisje për furnizim me energji elektrike
- panel solar dhe bateri
- tokëzim.

Varianti i parë vendoset në terrene ku ka tokëzim të mirë, kurse varianti i 2 në terrene ku nuk ka tokëzim të mirë, i cili është me rëndësi të jashtëzakonshme që gardhi të punojë.

Pa marrë parasysh vendosjen e gardhit dhe fuqinë e tij në të duhet të vendosen me patjetër mbishkrime se gardhi është me rrymë elektrike. ●



MBJELLJE ME PËRPUNIM MINIMAL TË TOKËS

MËNYRA E KRYERJES SË KËSAJ MBJELLJEJE ËSHTË E THJESHTË DHE KRYHET ME HEDHJEN E PLEHUT DHE TË FARËS NË SIPËRFAQE TË PALËRUAR DHE ME KALIM TË NJËFISHTË ME FREZË ROTACIONI NË THELLËSI PREJ RRETH 5-10 CM KUR MBILLET PARCELË E CILA KA QENË E MBJELLË MË PARË ME KULTURË DRITHI.

Shkruan: agr. i dipl. Vanço Zahariev



Problemet me përpunimin e tokës për mbjellje, ku ka kashtë, janë shumë të komplikuar për shkak të ndikimit të përbashkët të shumë faktorëve të cilët ndikojnë bashkërisht mbi pjellorinë e tokës.

Nëpërmjet përpunimit rregullohen vetitë fizike-mekanike, aktiviteti biologjik, regjimi i ujit dhe lufta me barërat e këqija në shtresën e tokës ku vendoset sistemi rrënjor i kulturave të drithërave.

Mangësitë kryesore të sistemit të përpunimit të tokave për mbjellje të kulturave të drithërave qëndrojnë në faktin që përpunimi kryhet me lërim në thellësi prej 20 cm dhe përdorimi i pendës pykë për lesim (në shumicën e rasteve) ose në vend të pendës për lesim të truallit dhe mbulim të farës përdoren grebashka, para dhe gjatë vetë mbjelljes.



Me pendën pykë pothuajse asgjëkund dhe asnjëherë nuk është bërë një renditje dhe mbulim i mirë i farës, kurse këmbëngulet që të kryhet kjo gjë, në shumicën e rasteve, në varësi nga lloji i tokës, zmadhohet ngjeshmëria e shtresës së tokës, nuk ka përcjellshmëri të mirë të ujit, nuk ka avullim të mirë dhe pengohet mbirja, që së bashku ndikojnë negativisht gjatë gjithë vegetimit të kulturave të drithërave.

Këto mangësi nuk i kanë grebashkat. Mungesa e tyre e vetme është se në disa raste dhe në disa lloje tokash me to nuk mund të kryhet lesim i mirë.

Për të dyja kombinimet është e rëndësishme të thuhet se janë joekonomike sepse puna është e dyfishtë përkatësisht punohet me një pajisje, kurse pastaj punohet edhe me pajisjen tjetër, kurse kjo është harxhim kohe dhe energjie.



Duke u nisur nga vëzhgimet e këtyre mangësive dhe nga njohuritë e përvojat bashkëkohore të shkencës në këtë pjesë (përpunimi mekanik i tokës kryhet me qëllim që të përmirësohet struktura e tokës, përkatësisht që shtresa e tokës të ketë peshë optimale specifike të vëllimit për zhvillim të bimëve, si dhe nga fakti se edhe përkrah rendimenteve të lartë deri 10t/ha në kultivimin bashkëkohor të kulturave të drithërave shpenzimet për kg/ të ardhura janë shumë të larta, sepse shërbimet makinerike në rajonin tonë paguhet me 8.000-12.000 den/ha për mbjellje të një sipërfaqeje për një hektar) është mirë të praktikohet mbjellja e kulturave të drithërave me përpunim minimal.

Mënyra e kryerjes së kësaj mbjelljeje është e thjeshtë dhe kryhet me hedhjen e plehut dhe të farës në sipërfaqe të palëruar dhe me kalim të njëfishtë me frezë rotacioni në thellësi prej rreth 5-10 cm kur mbillet parcelë e cila ka qenë e mbjellë më parë me kulturë drithi. Nëse më parë parcela ka qenë e mbjellë me misër, përpunimi përfshin një kalim me frezë me të cilën kryhet copëtim i imët kërcejve të misrit, pa kësaj vijon hedhja e plehut dhe farës, pastaj kryhet edhe një kalim me frezë me të cilën kryhet imtësimi i kërcejve dhe futja e plehut dhe farës në tokë. •



ANË POZITIVE TË TEKNIKËS

- Zbatohet te të gjitha llojet e tokave të cilat kanë teksturë rrënore, argjilore;
- Mënyrat klasore të përpunimit (sidomos ato që përdoren te ne) nuk mund të japin një peshë specifike vëllimore të shtresës së përpunuar siç rezultojnë nga kjo mënyrë e përpunimit;
- Mbulimi i farës, thellësia dhe dendësia e mbjelljes afrohen me optimumin;
- Zbatohet edhe në toka në të cilat kanë mbetje më të imta dhe më të ashpra bimore (i copëton në pjesë të imëta, i fut dhe i rendit më mirë se të tjerat);
- Barërat e këqija eliminohen ose janë në kufijtë e tolerancës, kështu që anashkalohet trajtimi kimik, kurse kështu zvogëlohen shpenzimet dhe ndotja e prodhimit, e tokës dhe e mjedisit.

PËRPUNIMI I KASHTËS


Shpenzimet zvogëlohen theksueshëm. Si anë negative e kësaj mënyre të mbjelljes mund të jetë:

- Kashta që mbetet nga korrja e mëparshme mund të shfaqet si problem me reflektim negativ në rendiment sepse e pengon përpunimin dhe shpërhapjen e farës, para së gjithash, mbirjen e saj, përkatësisht kemi kulturë drithi jo të dendur që ndikon në raportin përkatës negativ me rendimentin.

Por, kjo mund të eliminohet nëse kashta, aty ku nuk mbledhet, pas korrjes duhet të shpërhapet njëtrajtësisht në të gjithë sipërfaqen me qëllim që të fillojë procesi i shpërbërjes së saj dhe krijimi i mundësisë për përpunim me parametra optimalë

Mbledhje e shpejtë dhe efikase

Shkruan: prof. dr. Dragi Tanevski



Gjatë shkuljes së patates zihet një sasi e madhe e masës së përgjithshme. Për çdo një metër gjatësi përfshihen 2-3 kg patate, por dhe 60-80 kg truall (edhe për gjatësinë më të vogël prej 12-14 cm). Gjatë shkuljes së patates prej një hektari ngrihet dhe ndahet nga trualli rreth 900-1200 t tokë, ndonjëherë edhe deri në 1.600 t.

Që të punojnë mirë makineritë për shkuljen e patates nevojitet që të plotësohen këto kërkesa agroteknike:

- parcelat duhet të jenë të rrafshuara mirë
- shtresa e sipërfaqes duhet të jetë e shkërmoqur mirë

- gjatë shkuljes radhët duhet të jenë të drejta
- sipërfaqja duhet të jetë e pastër pa barëra të këqija
- numri i radhëve të mbjelljes duhet të jetë në harmoni me numrin e radhëve të makinerisë për shkulje
- kupet e formuara gjatë rritjes duhet të jenë me lartësi të njëjtë
- trualli duhet të jetë i shkërmoqur etj.

Makineritë për shkuljen e patates duhet t'i plotësojnë këto kërkesa:

- t'i shkulin patatet me sa më pak humbje

- të mos i dëmtojnë patatet
- patatet t'i veçojnë nga toka, rrënjët etj.
- të ngrenë sa më pak tokë
- të angazhohen sa më pak njerëz etj.

Faza e parë gjatë shkuljes të patates është largimi i pjesëve të sipërme të patates. Ato duhet të hiqen paraprakisht sepse prania e tyre çon në ngecjen e pajisjeve për shkuljen e patateve, sepse mbështillen rreth pjesëve që rrotullohen, kurse e zvogëlojnë, gjithashtu, dhe efikasitetin e pjesëve të punës që bëjnë veçimin. Pjesët e sipërme duhet të largohen nga parcela.



SHKULËSI ME TRANSPORTUES PËR SITJEN E TRUALLIT

Këta shkulës përdoren më shpesh në toka të lehta dhe mesatarisht të rënda. Përpunohen në një pse dy radhë. Ngritjen e zhardhokëve e bëjnë shkulësit janë me shumë pjesë.

Zhardhokët e shkulur me tokë vendosen në transportues zinxhir ku janë vendosur thupra metalike ku ndodh ndarja e tokës nga zhardhokët, kurse me ndihmë të sitës i drejton zhardhokët e shkulur, plisat e dheut dhe brukthin nga sipërfaqja e parcelës në lenta që ta lehtësojë mbledhjen e zhardhokëve.

SHKULËS ME PJESË ROTUESE TË PUNËS

Shkulësit me pjesë rotuese të punës përbëhen nga një plug i rrumbullakët i cili futet nën zhardhokët e patates dhe i kap së bashku me dheun dhe pjesët e tjera. Masa e nxjerrë e kap rotorin me gishtërinj elastikë çeliku dhe e hedh anësh në sitën e cila mund të jetë prej thuprash metalike apo prej beze me ndihmë të të cilëve zhardhokët e nxjerrë vendosen në një lentë për mbledhje më të lehtë me dorë. Me ndihmë të rrotës mbështetëse rregullohet thellësia e shkuljes.

Rrota shërben për stabilitetin e shkulësit. Me qëllim që të mbrohen zhardhokët nga dëmtimi, majat e gishtërinjve janë përkulur në drejtim të kundërt me rrotullimin. Për shfrytëzim të drejtë të shkulësve, është e nevojshme që të sigurohet regjim i rregullt kinematik i punës, d.m.th. harmonizim me shpejtësinë periferike (e cila lëviz nga 3 deri në 3,5 m/s) me shpejtësinë e lëvizjes së agregatit.

Përveç produktivitetit të ulët të kësaj metode të shkuljes, zhardhokët e shkulur dëmtohen prej goditjeve të gishtërinjve, kurse rreth 8-12% prej tyre mbeten të mbuluar me tokë. Këta zhardhokë mbledhen me dorë me ndihmë të grabujës, prandaj nevojitet fuqi pune shtesë.

Nxjerrja më e mirë e zhardhokëve nga truall arrihet me një çift rotorësh me gishtërinj çeliku elastikë, ku rotorin i dytë shërben vetëm për shkuljen e zhardhokëve dhe mirëmbajtjen e tyre në sipërfaqen e parcelës. Shkulësi merr fuqi nga cilindri i vendosur në traktor.



KOMBAJNA PËR SHKULJEN E PATATES

Bëhet fjalë për makineri komplekse të cilat e shkulin patatën, e largojnë truallin, kurse patatën e mbledhin në bunker, thasë apo e transportojnë drejtpërdrejt në rimorkio. Në këtë mënyrë zvogëlohet pjesëmarrja e njeriut në punë.

Ndarja mekanike e plisave dhe gurëve paraqet akoma problem për përdoruesit dhe ndërtuesit e makinerive dhe sipas rregullit për këtë punë përdoret më tepër fuqi pune njerëzore. Vetëm në kushte të përshtatshme patatja shkullet me kombajn dhe ndahet me sukses mekanikisht toka, gurët dhe plisat me prani të vogël të fuqisë së punës. Kjo para së gjithash ka të bëjë me patatën që përdoret në industrinë e përpunimit, ndërsa për shkuljen e patates së konsumit nevojiten më tepër punëtorë për mbledhje.

Kombajna zvarritëse për patate shpesh përbëhen nga korniza, rrotat, ruli, plugu, thika, lentat e transportit për veçim të tokës, ngritësit e lentave, lentat për heqje të mbetjeve bimore, elevator rotacion me ndarje, ndarës, veçues, lenta për mbledhje, bunker, pajisje hidraulike për mbyllje, platformë për punëtorët, mekanizëm transportues etj. Të gjitha pjesët lëvizëse të kombajnë marrin fuqi nga ruli i vendosur në traktor. Në transferim marrin pjesë: rrotat me dhëmbë, rripat, zinxhirë, bashkues etj. ●



FNF rekomandime dhe përpjekje për zgjidhje të problemit të plasmanit dhe ndikimet negative të ndryshimeve klimatike mbi bujqësinë

Federata Nationale e Fermerëve nëpërmjet sistemit të vet sektorial për lobim këtë vit i ka analizuar gjendjet në lidhje me blerjen dhe plasmanin e prodhimeve bujqësore. Siç duket edhe nga gjendja në terren pamja nuk është aspak e mirë, vitet e fundit çmimet prodhuese të prodhimeve bujqësore janë zmadhuar, kurse çmimet blerëse zvogëlohen. Nga ana tjetër bujqit janë nën ndikim të dukurive negative të ndryshimeve klimatike të cilat shkaktojnë dëme të mëdha në të gjithë sektorët e bujqësisë. Pikërisht për këto probleme dhe sfida në bujqësi Federata Nationale e Fermerëve i analizoi gjendjet dhe këtë vit e organizoi Forumin e parë bujqësor “Mundësitë e tregut dhe ndryshimet klimatike” i cili i mbajti më 13.06.2018 dhe ku janë përcaktuar rekomandimet e veçanta, për të cilat ka pasur edhe diskutim shtesë në suazat e vetë organizatës dhe pas miratimit të rekomandimeve nga Këshilli Drejtues i FNF-së, në formë me shkrim i dorëzuar në Ministrinë e Bujqësisë, pyetje dhe ujërave. Federata Nationale konsideron se këto probleme janë me rëndësi thelbësore dhe për zgjidhjen e tyre nevojitet që të veprojnë të gjitha subjektet e involvuara në sektorin bujqësor, prandaj edhe publikisht po i japim kërkesat tona për të cilat në periudhën në vijim do të kryhet lobim që të realizohen.

Federata Nationale e Fermerëve i jep këto rekomandime për të cilat duhet të kihet qasje serioze dhe të cilat duhet t'i punojmë se bashku që të zbatohen.

- Vendorsje e një sistemi të unifikuar për llogaritje të çmimit prodhues
- Edukim i bujqve për llogaritje të drejtë të çmimit prodhues
- Funksionim i Sistemit Informatik të Tregut nëpërmjet të cilit do të ndiqen çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë.
- Respektim dhe zbatim i Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për prodhimtarinë e dakorduar ku është përcaktuar qartë forma dhe përmbytja e marrëveshjes për blerje.
- Zhvillim dhe përforsim i kooperativave bujqësore
- Vendorsje e Rregullores dhe dispozitave ligjore për shitjen e pragut të shtëpisë që është praktikë në vendet evropian, ku bujqit sipas standardeve të caktuara prodhojnë përpunime të prodhimeve bujqësore siç janë marmelata, bulmetra, verë, likere që të mund t'ua shesin nga shtëpitë e veta personave individualë dhe subjekteve juridike.

FNF rekomandime për adaptim të bujqësisë me ndryshimet e reja klimatike dhe mbrojtjen e bujqësisë:

- Edukim i bujqve dhe kuadrit profesional mbi masat adaptuese për bujqësinë në bazë të ndryshimeve të reja klimatike.
- Instalim dhe furnizim me stacione meteorologjike në mjediset bujqësore rurale.
- Përpilim i analizës dhe strategjisë për prodhime alternative të cilat do të përputhen me ndryshimet e reja klimatike.
- Pastrim në kohë i kanaleve të ujërave dalëse
- Kthim i raketave kundër breshrit
- Sistemet për ujtitje të fillojnë nga fundi i marsit që të ndërmerren masa parandaluese kundër ngricave dhe të fillohet në kohë ujtitja.
- Mjetet mbrojtëse, sistemet kundër ngricave, instalimi i ventilatorëve, mbulesat mbrojtëse të jenë pjesë e Programit për mbështetje financiare dhe zhvillim rural dhe të zmadhohet mbështetja për to.

Çmim i ulët blerës për grurin në RM

Çmimi minimal i grurit të jetë 12 denarë për kg dhe kontratat në të cilat do të shkruhet çmimi dhe afati i pagesës që të lidhen para korrijës, në përputhje me Ligjin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Të zbatohet blerje intervenuese e grurit, në përputhje me Ligjin kur çmimi është më i lartë se ai blerës, çmimi intervenues duhet të përcaktohet me vendim të Qeverisë. Sipas të dhënave të tregut të bursës për muajin korrik, Maqedonia ka çmimin më të ulët të blerjes prej 8.5 denarë për kilogram, ndërsa në Kroaci çmimi është 8.84 denarë për kilogram, në Serbi çmimi është 9.12 denarë për kilogram dhe në Bullgari çmimi është 10.55 denarë për kg.



Vizitë studimore e grave fermere në Korçë, Shqipëri



Vizitë e grave fermerë të FNF-së në Korçë, Shqipëri, organizuar nga Agrinet. Gjatë vizitës, u zhvillua një takim me Qendrën për bagëtinë e cila është në pronësi shtetërore të Shqipërisë dhe e cilazbaton edukim të fermerëve dhe shet deshe racorë me çmime të përballueshme që mundësojnë zhvillimin e kopeve. Njëkohësisht është vizituar edhe një fabrikë për përpunimin e frutave, që ndodhet në fshatin Dvoran, ku fermerët shesin mollë të klasit të tretë këtu sipas marrëveshjes së dakorduar. Pronari Jorgo vuri në dukje dy gjëra të rëndësishme në bujqësi: "Ne blerësit si kudo duam të blejmë produkte nga fermerët me çmime të ulëta edhe pse e dimë se sot ata prodhojnë ushqim me shumë përpjekje dhe me kosto të lartë. Atë ushqim e dëshirojnë dhe e blejnë shtetet e pasura dhe të zhvilluara, kurse neve na shesin lëngje artificiale, pije energjie dhe ushqime të shpejta për të cilat ne si të çmendur bëhemi të varur prej tyre."



Vizitë studimore e anëtarëve të rinj të Klubit të Prodhimit të Integruar të Mollës në Pirgoi, Greqi

Shkruan: Nikolin Karapanci

Prodhimi dhe zhvillimi i biznesit dhe sidomos rritja e ndërgjegjësimit të fermerëve drejt arritjes së standardeve të Bashkimit Evropian është një nga komponentët kryesorë të projektit “Fuqizimi i Komunitetit për një Zhvillim Rural të Qëndrueshëm” të cilin AgriNet Albania është duke e implementuar me mbështetjen e We Effect, Suedi, në rajonet Korçë, Elbasan dhe Dibër.

Në këtë kuadër u zhvillua një vizitë për shkëmbim eksperience në një nga zonat më të njohura të prodhimit të mollës në fshatin Pirgoi të rajonit të rajonit të Edesas në Greqi me anëtarët e rinj të Klubit të Prodhimit të Integruar të Mollës kryesisht nga rajoni i Korçës.

Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte njohja me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të organizatave të fermerëve në këtë rajon, njohja me teknologjitë e reja të prodhimit të mollës me programin e Prodhimit të Integruar sipas standardeve të Komunitetit Evropian.

Grupi i vizitoreve i përbërë prej 41 fermerësh u prit në ambientet frigoriferike të grumbullimit të prodhimit prone e “Shoqatës Bujqësore Pirgoi”, nga specialisti z. Jorgo Katsizis. Zoti Jorgo prezantoi para vizitoreve të gjithë historikun e krijimit dhe të funksionimit të kooperativës por pa harruar të futej dhe në detaje për teknologjitë e reja të kultivimit të frutave duke bërë kështu një pasqyrë të plotë për:

- Domosdoshmërinë e krijimit të kooperativës;
- Avantazhet, disavantazhet, mbështetja që jep qeveria (në formë grantesh dhe subvencionesh) për të qenit i organizuar në një kooperativë;
- Përfitimet e anëtarëve të kooperativës (blerjen e imputeve bujqësore me çmim të ulët dhe shitjen e prodhimit të organizuar me çmim më të lartë);
- Aplikimin e teknologjive të reja në kultivimin e mollës (zgjedhja e

nënshartesës dhe fidanit, ngritja e pemtores, aplikimi i sistemeve mbrojtës ndaj breshrit etj.);

- Mënyrën e monitorimit dhe të mbrojtjes nga sëmundjet dhe dëmtuesit;
- Vjeljen, ruajtjen dhe marketimin e prodhimit.

Në shoqërimin e specialistit u realizuan vizita në terren në disa parcela të kultivuara kryesisht me mollë, qershi por dhe me dardha, në të cilën dallohej shumëllojshmëria dhe cilësia e fidanëve të mollës, aplikimi i sistemeve mbrojtës ndaj breshrit si dhe pastërtia e pemësorëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

Mes pyetjeve dhe diskutime të vizitorëve u krijuan përshtypje pozitive mbi domosdoshmërinë e organizimit të tyre në organizata fermerësh si dhe për aplikimin e teknologjive bashkëkohore e cila lehtëson ndjeshëm punën në fermë duke i çuar të gjitha proceset drejt mekanizimit dhe njëkohësisht shtimin e sasisë dhe cilësisë së prodhimit. ●



Formimi i Grupit teknik të të rinjve “Zvirina - Fruit”

Shkruan: Nikolin Karapançi

Në Shqipëri pas ndërrimit të sistemit politiko/ekonomik fenomeni i braktisjes së jetës në fshat dhe punës në bujqësi nga të rinjtë u bë shumë akut për faktin sepse jeta dukej e vështirë dhe me të ardhura të vogla. Kështu që shumica e të rinjve iu drejtuan qendrave urbane dhe emigracionit drejt vendeve të Bashkimit Evropian kryesisht Greqi, Itali etj. Në ditët e sotme tendenca e të rinjve për t'u larguar nga fshati nuk mund të themi që është eliminuar fare por kohët e fundit ky fenomen sa vjen dhe zvogëlohet duke parë që shumë të rinj vazhdojnë jetën në fshat për të punuar në fermat e tyre por dhe shumë të tjerë janë kthyer nga emigracioni. Përveç kësaj të rinjtë kanë pak dëshirë për të punuar në fermë, duke detyruar prindërit e tyre të punojnë për një kohë më të gjatë dhe në një moshë më të madhe.

Prandaj dhe nxitja e të rinjve për të punuar në fermë është një nga objektivat kryesorë të Agrinet Albania mbështetur nga We Effect. Ky fakt ka bërë që të përkrahet një iniciativë e tillë e ndërmarrë nga një grup prej dymbëdhjetë të rinjsh anëtarë të Shoqatës së Fermerëve Zvirinë për krijimin e grupit teknik të të rinjve «ZVIRINA - FRUIT». Grup i cili do të ketë si fokus kryesor shërbimet në frutikulturë siç janë krasitja, rrallimi, trajtime mbrojtëse në frutikulturë (spërkatjet) dhe vjelja, duke shërbyer jo vetëm në fermat e tyre por dhe tek anëtarët e tjerë të shoqatave.

Duke punuar dhe shpresuar që ky grup dhe kjo iniciativë e këtyre të rinjve të shërbejë si një shembull dhe praktikë e mirë për nisma të ngjashme jo vetëm në rajonin e Korçës por dhe më gjerë, për të arritur tek një e ardhme e sigurt dhe e qëndrueshme e zhvillimit rural.●



TAKIMI RAJONAL

“Lidhja e aktorëve dhe nismave vendore për praktika të qëndrueshme në zhvillimin rural”



Shkruan: Tomi Pikuli

Takimi rajonal “Lidhja e aktorëve dhe nismave vendore për praktika të qëndrueshme në zhvillimin rural” u organizua nga organizata AgriNet Albania në kuadër të projektit “Rrjetëzim për zhvillimin rural” organizuan në 12 qarqet të Shqipërisë, të cilat sollën së bashku rreth 250 pjesëmarrës. Nëpërmjet forumeve vendore u arrit të identifikohen aktorët aktivë dhe nisma vendore në zhvillimin rural (agroturizëm, agrobiznes, trashëgimi kulturore, bujqësi dhe ferma familjare, slow-food, promovimi i territorit, mjedis, artizanat, etj.) nëpër gjithë vendin. Në këtë takim i cili synon të fuqizojë aktorët vendore për të influencuar një mjedis inkurajues për zhvillimin e qëndrueshëm rural morën pjesë 35 pjesëmarrës nga tri qarqet e rajonit jug-lindor të Shqipërisë ato të Korçës, Elbasanit dhe Beratit.

Modele pozitive dhe praktika të mira ishin evidentuar për t'u ndarë me pjesëmarrësit në takimin rajonal, praktika të cilat lidheshin me identifikimin e nismave dhe sipërmarrjeve të cilat kanë mundur të sjellin përfitime për banorët e zonave rurale, veçanërisht në ato zona të izoluara e të shkëputura nga proceset zhvillimore. Këto nisma dëshmojnë leadership vendor dhe përvojat në këtë janë të ndryshme si, nisma të iniciuara nga një individ, në një komunitet tjetër nga Bashkia, apo nga organizata të shoqërisë civile.

Takimi gjithashtu u rrek të ofronte dhe plotësonte në një ndërveprim dinamik me pjesëmarrësit një hartëzim të rajonit përkatës në lidhje me aktorët, nismat dhe tematika të zhvillimit rural në rajon. Vëmendje të veçantë në këtë hartëzim iu kushtua integritetit të “Programit të zhvillimit të integruar të 100 fshatrave”. Në këtë kuadër fokusi i diskutimeve kaloi në këto pika:

- Si mund të plotësohen dhe krijojnë sinergjitë dy perspektivat (nga lart-poshtë dhe poshtë-lart) për impakt të rritur dhe afatgjatë të ndërhyrjeve zhvillimore në zonë;
- Në ç’mënyrë kapitali që ofrojnë aktorët vendor mund të përdoret dhe përfshihet në funksion të prioritetëve vendore dhe njëherësh zbatimit efektiv të programit;
- Në ç’mënyrë programi i 100 fshatrave mund të fuqizojë dhe mbështesë më tej nismat e iniciuara nga aktorët vendor.

Ky aktivitet do të vazhdojë me formalizimin e forumit rajonal të zhvillimit rural, me qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile. •

Takime informuese

“Rrjetëzim për zhvillimin rural me pjesëmarrje”

Shkruan: Dr. Vitor Malutaj

Gjatë muajve qershor dhe korrik 2018, Shoqata Agropuka organizoi takimet informuese në Qarkun Shkodër, Lezhë dhe Kukës “Rrjetëzim për zhvillimin rural me pjesëmarrje” të cilat u organizuan në kuadër të projektit “Konsolidimi i rolit të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural drejt një modeli funksional të perspektivës me pjesëmarrje dhe poshtë-lart në agjendën kombëtare rurale”, i cili mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe që po zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në partneritet me organizatat AgriNET dhe AgroPUKA. Ky projekt, ndër të tjera, synon ngritjen e Forumeve Vendore që të identifikojnë, inkurajojnë dhe përfshijnë në proceset e formulimit dhe zbatimit të politikave dhe instrumenteve të zhvillimit rural, nismat lokale të ndërmarra nga individë, grupe, shoqata, bërthamëza dhe komunitete të ndryshme në zhvillimin rural në mbarë territorin e vendit. Në këto takime morën pjesë mbi 100 persona përfaqësues të shoqërisë civile, biznesit, nismave lokale, grupeve dhe komuniteteve të ndryshme, të cilët dhanë mjaft ide dhe sugjerime për zhvillimin rural.

Në përpjekje për të krijuar një ambient nxitës dhe mbështetës për nismat vendore që individë, familje apo grupe komunitare kanë ndërmarrë në zhvillimin rural, nëpërmjet një pyetësori u dokumentuan disa nga nismat si modele për t'i promovuar më tej në të gjithë vendin.

ÇFARË MËSUAM ?

- Burimi më i madh i çdo territori janë njerëzit, njohuritë, trashëgimia, përkushtimi dhe entuziazmi i tyre.
- U evidentuan llojshmëri të nismave lokale të iniciuara nga aktorë vendore. Nisma që kanë gjeneruar përfitime për banorët e zonave rurale.
- Nisma, sipërmarrje që mbështeten në trashëgiminë kulturore, pasuritë natyrore, kulinarinë e pasur etj. të vendit tonë.
- U arrit ne konkluzionin se nuk ka territore të harruara por territore pa projekt.
- Rikthimi i shpresës për banorët e zonave të thella se “përmes turizmit mund të jetohej”.
- Nisma që bëjnë të qartë se përgjegjësia kryesore për komunitete të zhvilluara bie fillimisht mbi vetë banorët e zonave rurale – grupeve të ndryshme, bizneseve, familjeve dhe organizimeve të ndryshme që të marrin rolin e aktorit të ndryshimit në komunitetet e tyre.
- Sfidat që sipërmarrjet ndeshin lidhen me mungesën e një mjedisi mbështetës: kuadër ligjor, taksime, infrastrukturë, kreditim etj.
- Nëse duhet të flitet për problemet dhe interesat e komuniteteve rurale, personat, liderët e nismave mund të artikulojnë më fort sfidat në emër të banorëve të zonave rurale.

Projekti do të vazhdojë deri në vitin 2020 dhe do të japë një kontribut të çmuar në zhvillimin rural me pjesëmarrje. ●





Festivali i mjaltit

“Ditët e ëmbla në Tetovë”

Shkruan: Dr. Vitor Malutaj

Shoqata e bletarëve “Qyteti i bletëve” nga Tetova, në Republikën e Maqedonisë, më datë 28 dhe 29 korrik, 2018, në bashkëpunim me Komunën e Tetovës, organizuan Festivalin e mjaltit nën moton “Ditët e ëmbla të Tetovës”.

Festivali i mjaltit “Ditët e ëmbla të Tetovës” – promovoi kapacitetin që ka Pollogu për produktet e mjaltit, traditën, risitë dhe inovacionin në fushën e prodhimit e përpunimit të mjaltit dhe produktet e tjera të bletarisë. Në festival morën pjesë trajnues nga Bosnja, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, të cilët mbajtën ligjërata rreth bletnimit, ndërsa vizitorë ishin një numër i madh bletarësh nga Maqedonia dhe shtetet përreth. Ky festival, i pari i këtij lloji në Tetovë, mëton të bëhet tradicional. Jetojmë në një periudhë, në të cilën sektori i bletarisë më shumë se kurrë më parë tërhiqet nga dy prirje në dukje në kah të kundërt. Nga njëra anë teknologjizimi e industrializimi, në kërkim të rritjes së prodhimit por pa kualitet dhe nga ana tjetër tërheqja e fuqishme drejt produkteve natyrale e tradicionale të prodhimit të mjaltit që është karakteristikë e bletërritësve të Pollogut. Në kuadër të festivalit kishte edhe:

BEE SHOW

“Ditët e ëmbla të Tetovës” ishte një ekspozitë e vërtet me produkte të mjaltit të të gjitha formave që bletarët ekspozuan, ndërsa vizitorët përveç që provuan dhe diskutuan për produktet e mjaltit u informuan rreth bletës, mjaltit, polenit, propolisit, qumështit të bletëve etj.

Përveç kësaj, bletarët patën mundësinë të blinin edhe mjete të ndryshme të bletarisë, nga kompanitë që merren me prodhimin dhe tregtimin e tyre, të ekspozuara në panair.

Shumë institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare kishin info/tezgat e tyre që informuan bletarët për subvencionimin, ndihmën financiare, programet zhvillimore që ofrojnë për zhvillimin e këtij sektori shumë domethënës për natyrën e njeriun.

BEE ART SHOW

Arti paraqet një pasqyrim estetik të realitetit që na rrethon dhe imagjinatës së bujshme njerëzore, por njëkohësisht jep mesazhe të forta tek qytetari, mu në shpirt, pa shumë fjalë, për dukuritë që na rrethojnë.

Ky mesazh sublim, u përcoll nëpërmjet “BEE ART SHOW”, në një fushë specifike atë të botës së bletës. Ishin fëmijët të cilët me imagjinatën e tyre na mësuat shumëçka për bletën, sidomos atë që të rriturit shpesh e neglizhojnë.

BEE FRIENDLY GARDEN

Studiuesit kanë vërtetuar se mbjellja e kopshteve miqësore të bimëve që i duan bletët në komunën ku jetojmë mund të rrisë shumëllojshmërinë, madje edhe brenda zonave urbane të ngarkuara me beton ku banojnë shumë prej nesh.

Prandaj në parkun e rezervuar nga Komuna e Tetovës, ditën e parë të Festivalit, pjesëmarrësit dhe bletarët mbollën bimë miqësore të bletës në parkun e titulluar “BEE FRIENDLY GARDEN”, i cili njëkohësisht është parku i parë në Maqedoni me këtë emër i cili do të mbillet me qëllim sensibilizimi.

Ky eveniment, hapi dritare shumë dimensionale: do të rrisë gjelbërimin brenda territorit të komunës, do të jetë një pikëfillim ku jo vetëm brenda hapësirave publike por edhe në kopshtet private dhe ballkonet e qytetarëve të fillohet të mbillen bimë që janë miqësore me bletët.

LEARNING BEE

Gjatë dy ditëve të Festivalit, u mbajtën shumë ligjërata të rëndësishme dhe interesante rreth bletës dhe mënyrën e trajtimit të saj. Profesorë universitar si dhe bletarë profesionist nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova dhe Bosnja dijen e tyre nëpër mes ligjëratave u munduan ta transmetojnë tek të gjithë të interesuarit. Qëllimi i këtyre ligjëratave ishte vetëdijesimi dhe aftësimi i bletarëve në lëmin e bletarisë.

Bletët e afrikanizuar kanë kimi te ndryshme nga ato joafrikane

Shkruan: Dr. Vitor Maluta

Bletët afrikane, zakonisht të njohur si «bletë vrasëse», janë shumë më agresive sesa bletët evropiane. Tani studiuesit kanë ekzaminuar ndryshimet e neuropeptidit që ndodhin në trurin e bletëve afrikane gjatë sjelljes agresive. Hulumtuesit, të cilët raportuan gjetjet e tyre në Journal of Proteome Research, treguan gjithashtu se ata mund të kthejnë bletët e buta në agresive duke i injektuar ato me peptide të caktuara.

Në vitet 1950, studiuesit në Brazil krijuan bletët e afrikanizuar duke kryqëzuar bletët evropiane dhe afrikane. Në vitin 1957, rojtje të bletëve u lëshuan në natyrë, dhe ata kanë qenë duke ecur nëpër Amerikë që atëherë. Shkencëtarët aktualisht nuk e kuptojnë se çfarë



i bën këto bletë aq agresive, por sjellja duket se përfshin një rrjet kompleks të faktorëve gjenetik dhe mjedisor, të rrëgulluar nga neuropeptidet. Kështu, Mario Sergio Palma dhe kolegët e tij donin të shqyrtonin dallimet e neuropeptideve midis trurit të bletëve që shfaqnin sjellje agresive dhe joagresive.

Hulumtuesit stimuluan bletët e afrikanizuar për të sulmuar duke varur sende sferike, të zeza lëkure para

kolonive të tyre. Bletët e zemëruara "gardiane" sulmuan shpejt objektivat, duke u ngulitur në lëkurë thumbat e tyre. Ndërkohë, bletët e buta e mbanin distancën. Hulumtuesit mblodhën të dyja grupet e bletëve dhe analizuan trurin e tyre me anë të imazhit të spektroskopit masiv.

Në trurin e bletëve agresive, dy neuropeptide më të gjata u copëtuan në ato më të shkurtra, por kjo nuk ndodhi në bletët e buta. Hulumtuesit pastaj injektuan peptide më të shkurtra në bletë të anestezizuara, jo agresive, të cilat u bënë të ashpra me zgjimin. Studimi ofron njohuri të reja në bazën neurologjike për sjelljen agresive të bletëve, thonë studiuesit. •



Ambasadorja e BE në Tiranë znj. Vlahutin dhe Ministri i Bujqësisë z. Peleshi vizituan shoqatën Agropuka

Me 25 qershor 2018, Ambasadorja e BE në Tiranë znj. Vlahutin dhe Ministri i Bujqësisë z. Peleshi vizituan shoqatën Agropuka.

Gjatë kësaj vizite ata bashkëbiseduan me fermerë, autoritete të qeverisjes vendore, përfaqësues të organizatave dhe projekteve të tjera në Pukë si dhe me drejtues të shoqatës Agropuka. Me këtë rast fermerët paraqitën problemet që kanë për prodhimin, shitjen dhe aspekte të tjera të zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë dhe agroturizmit. Gjatë drekës së punës me produkte lokale z. Niko Peleshi dhe znj. Vlahutin lancuan nismën «Zemra e malit» logoja e produkteve të prodhuara në zonat malore që është një bashkëpunim midis MBZHR-së dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. (European Union in Albania)

Shoqata Agropuka ka marrë edhe një Letër falënderuese nga Ambasadorja e BE-së në Shqipëri, znj Romana Vlahutin për punën e zhvilluar nga kjo shoqatë.

Bashkëpunimi i fuqishëm - një sukses i ëmbël

Të rinjtë e Pukës, me mbështetjen e fuqishme të partnerëve: Agropuka, Korpusi i Paqes Shqipëri, dhe USAID përfunduan me sukses periudhën e trajnimit teorik-praktik si të rrisim bletët, vjelim mjaltin dhe të kemi më shumë mundësi zhvillimi në zonat rurale.

Pamje nga shpërndarja e certifikatave të trajnimit.



Initiative for Kosova Community (IKC) dhe panaireset bujqësore në Kosovë përgjatë viteve

Shkruan: Shqipe Shaqiri



Initiative for Kosova Community (IKC) po vazhdon traditën e organizimit të panaireset të produkteve bujqësore edhe gjatë vitit 2018. Si një ndër aktivitetet që e bëjnë të dallojnë IKC-në me punën e saj drejt zhvillimit rural, janë panaireset tradicionale të produkteve vendore kosovare të organizuara çdo vit, në komunat e Kosovës Juglindore.

Panaireset e prodhimeve bujqësore, po organizohen nga IKC-ja me qëllim që të kontribuojnë në promovimin e produkteve vendore, dhe jo vetëm. Ato gjithashtu po kontribuojnë të mbajnë më afër komunitetet me autoritetet lokale dhe ato qendrore. Këtë IKC-ja po e realizon duke u bërë urë lidhëse midis komuniteteve rurale dhe Komunave dhe institucioneve qendrore në Kosovë, duke i bashkuar në evenimente dhe aktivitete me pjesëmarrje të përbashkët, dhe duke nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë. Ky bashkëpunim po rezulton edhe me vetëdijesimin e grave dhe burrave të zonave rurale në Kosovë për të drejtat e tyre dhe për fuqizimin e tyre drejt realizimit të tyre.

Për më tepër, një rezultat i mirëpritur është edhe krijimi i lidhjeve dhe mundësive të reja me pjesëmarrjen e fermerëve në panaireset bujqësore. Të gjithë fermerët pjesëmarrës po shfrytëzojnë hapësirën dhe mundësitë që po ofrojnë panaireset, për ndërtimin e kontakteve të reja mes vete dhe me palët që janë me rëndësi për zhvillimin e tyre. Më shumë bashkëpunime, e më shumë njohje të reja të prodhimeve dhe punës së tyre është edhe synim i IKC-së. Pra, këto aktivitete janë pjesë e misionit lobues dhe avokues të IKC-së për të drejtat e grave dhe burrave të zonave rurale, dhe për zhvillimin e tyre të mëtutjeshëm. Kështu, IKC-ja po e vazhdon punën e saj duke bashkuar komunitete nga grupe të ndryshme etnike, institucione, aktorë relevantë, dhe kontribuues të zhvillimit rural nëpërmjet aktiviteteve të tilla.

Këtë vit, IKC-ja ka arritur numrin e rreth 30 panaireset të produkteve bujqësore të organizuara deri më tani në Kosovë. Këto panaireset kanë krijuar mundësi për të promovuar fermerë nga e tërë Kosova Juglindore dhe më tej, dhe sot IKC-ja gëzon njohjen si një kontribuues i jashtëzakonshëm në zhvillimin rural në Kosovë, me kredibilitet dhe përkushtim të lartë.





FNF



FEDERATA NACIONALE E FERMERËVE

Federata Nationale e Fermerëve e zgjeroi spektrin e vet të veprimit. Kjo do të thotë që përveç bujqve, shoqatave bujqësore, kooperativave bujqësore, organizata mandej do të punojë në përforcimin dhe mbështetjen e kategorive të lëndueshme në mjediset rurale, mbështetje më të madhe të të rinjve dhe grave si dhe për përfshirje të tyre të drejtpërdrejtë në zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet vendimmarrjes dhe veprimtarisë aktive. Përveç bujqve, një nga fokuset kryesore të organizatës është edhe zhvillimi rural përkatësisht tejkalimi i problemeve dhe sfida me të cilat ballafaqohet popullata rurale siç janë varfëria dhe qasja e kufizuar e popullatës rurale në shërbimet shëndetësore, edukim, informim, drejtësi dhe fuqi në vendimmarrje. Edhe mandej shtylla kryesore e veprimtarisë është lobimi në drejtim të përcaktimit të problemeve nga fusha që me punë e analizë të përbashkët do të prezantohen para institucioneve kompetente

që të gjendet zgjidhje e përbashkët, e cila do të jetë në interes të bujqve dhe të mirëqenies të të gjithë shtetit tonë. Fokusi i Organizatës Nationale të Fermerëve, edhe mandej do të funksionojë nën sloganin "Së bashku drejt suksesit" dhe nën logon e cila e simbolizon mundin dhe prodhimtarinë e bujqve tanë, është zgjidhja e problemeve më të mëdha, siç është plasmani dhe prodhimtaria cilësore. Misioni i organizatës së ribrenduar është: FERMER I ORGANIZUAR - LIDER NË ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE RAJONAL NË RM. Vizionin që ne synojmë ta arrijmë është: BUJQËSI FITIMPRURËSE - FSHAT I QËNDRUESHËM.

AGROPUKA



AGROPUKA është një shoqatë e prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë të rrethit të Pukës (Shqipëria e Veriut). Ajo është krijuar në 2001 me mbështetjen e Bashkëpunimit për Zhvillim të Zvicrës (SDC). Që nga ajo kohë, shoqata ka rritur anëtarësinë e saj dhe ka zgjeruar aktivitetin dhe shërbimet, për të plotësuar nevojat e anëtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Shoqata kontribuon në zhvillimin e integruar rural nëpërmjet inkurajimit dhe promovimit të zhvillimit ekonomik si dhe të iniciativave dhe veprimtarive për të përmirësuar jetesën e anëtarëve të AP dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë mënyrë AP ndikon në reduktimin e varfërisë dhe pa-drejtësive sociale në zonat rurale.

Nga viti 2011, Agropuka po zbaton projektin "Të kontribuojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetës së banoreve të zonave rurale të Pukës" që financohet nga We Effect (Suedi).

Projekti është në fazën e dytë të tij (2014-2016; faza e parë u zbatua gjatë 2011-2013) dhe synon përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimit të demokracisë dhe pjesëmarrjes lokale.

Në tre vitet e ardhshme shoqata do të përqendrohet në tre fusha: (1) Përmirësimin e kushteve të jetesës së anëtarëve të AP dhe të komuniteteve në zonat ku punon AP nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit, marketingut, dhe modeleve të kooperimit; (2) Promovimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; dhe (3) Promovimin e demokracisë lokale dhe përfshirjes sociale të komuniteteve rurale në vendim-marrjen lokale. Për këtë Agropuka do të rrisë qëndrueshmërinë, përgjegjësinë dhe kapacitetin organizativ të saj.



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY-IKC



IKC, Initiative for Kosovo Community është themeluar në vitin 2005 si një prej organizatave lokale joqeveritare në Kosovë. Ajo është formuar si spin-off organizatë e organizatës joqeveritare belgjiane Balkanactie vzw. Ajo është themeluar nga personeli lokal i Balkanactie vzw. Duke ditur se Kosova vuan nga shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë, përjashtim të grave nga aktivitetet socioekonomike, ne i drejtuam resurset tona kah zhvillimit socioekonomik të Kosovës. Momentalisht IKC-ja po zbaton dy projekte, një të financuar nga Kooperativa Suedeze We EFFECT, kurse tjetri i financuar nga Ambasada Britanike. Të dy projektet kanë për qëllim zhvillimin e shoqërisë rurale të Kosovës nëpërmjet

organizimit dhe zhvillimit të biznesit. Për faktin se IKC-ja i përfshin të gjitha grupet etnike, gjinitë dhe sidomos bashkësitë e marginalizuara, IKC-ja punon në 10 komuna ku për nevojat për punësim janë më tepër se kryesore: Ferizaj, Shtime, Lipjan, Viti, Klllokot, Stërpçe, Partesh, Han i Elezit, Kaçanik dhe Gjakova. Deri më tani IKC-ja ka organizuar mbi 700 bujq në organizata të grave (WOs) dhe në organizata bujqësore (FOS). Midis tyre, më tepër se 50% janë WOs, kështu që gratë përforcohen ekonomikisht, politikisht dhe në anën sociale.

FONDACIONI AGRINET ALBANIA



AgriNET është organizatë shqiptare apolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse e regjistruar në shkurt të vitit 2005 me seli në rajonin e Korçës. Tani ajo është rrjetë e 15 organizatave bujqësore nga tre rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj organizate është pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në proceset sociale, ekonomike dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive të cilat jetojnë në rajone rurale në partneritet me sektorët ruralë të marginalizuar, bashkësitë e tyre dhe palët e ndryshme të prekura. AgriNet e realizon misionin e vet nëpërmjet implementimeve të ndryshme në projektin në fushën e zhvillimit rural financuar nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare, si edhe nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësive, pushtetit lokal dhe organizatave të tjera joqeveritare në fushën e zhvillimit rural të bashkësisë. AgriNet siguron shërbime të

zgjeruara në pjesën më të madhe të rasteve për grupe formale dhe joformale të prodhuesve bujqësorë. Lloji kryesor i grupeve bujqësore për shërbime të zgjeruara janë: grupet e prodhuesve të cilët zbatojnë Praktika bujqësore të mira (Good Agricultural Practices - GAP), zbatim i trajnimeve të moderuara nga ekspertë në nivel nacional, organizim i shkëmbimit të përvojave për prodhuesit bujqësorë inovativë, organizim i parcelave demonstruese për testim dhe zbatim të teknologjive inovuese dhe zhvillim të publikimeve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e teknologjive inovuese dhe GAP.